Intersig Vienna Insurance Group sh.a.

Pasqyrat Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar më 31 dhjetor 2018

Përmbajtja

Raporti i Audituesit të Pavarur 1
Pasqyra e pozicionit financiar 2
Pasqyra e fitimit ose e humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse 3
Pasqyra e ndryshimeve në kapital 4
Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare 4

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare
1. Informacione të përgjithshme 5
2. Bazat e kontabilitetit 5
3. Zbatimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara 6
4. Standardet e reja kontabël 8
5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël 11
6. Vlerësimet dhe gjykimet në zbatimin e politikave kontabël 19
7. Administrimi i rrezikut financiar 20
8. Administrimi i rrezikut të sigurimit 26
9. Shënime shpjeguese për përcaktimin e vlerës së drejtë 31
10. Aktive të trupëzuara dhe të patrupëzuara 32
11. Aktive të mbajtura për investime 33
12. Aksione në shoqëri të lidhura 33
13. Aktive të risigurimit 33
14. Letra me vlerë me kosto të amortizuar 34
15. Depozita me afat me bankat 34
16. Aktive të tjera 35
17. Shpenzime të shtyra të marrjes në sigurim 35
18. Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimeve dhe të tjera 35
19. Mjete monetare dhe ekuivalente me to 36
20. Kapitali aksionar 37
21. Borxh i varur 37
22. Detyrime për kontratat e sigurimeve 37
23. Rezerva e primit të pafituar 38
24. Depozita e risiguruesit 38
25. Detyime tatimore dhe të ngjashme 38
26. Detyrime nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera 38
27. Detyrime nga aktiviteti i sigurimit të tjera 38
28. Primet e shkruara bruto 39
27. Prime të ceduara te risiguruesit 39
29. Të ardhura të tjera 39
30. Shpenzime të marrjes në sigurim 39
31. Shpenzime administrative 40
32. Të ardhura nga komisionet e risigurimit 40
33. Shpenzime të tjera të sigurimit 40
34. Të ardhura nga interesat 41
35. Të ardhura nga kursi i këmbimit, neto 41
36. Tatim mbi fitimin 41
37. Angazhime dhe detyrime rastësore 41
38. Shënime shpjeguese për palët e lidhura 42
39. Ngjarje pas datës së raportimit 43

Skedule suplementare
Aftësia Paguese i
Aktive për mbulimin e detyrimeve të sigurimit ii

pwc

Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar aksionarëve të Intersig Vienna Insurance Group sh.a

Opinioni ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin, në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të Intersig Vienna Insurance Group sh.a ("shoqëria") më 31 dhjetor 2018, si dhe performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Ne kemi audituar:

Pasqyrat financiare të shoqërisë përfshijnë:

- pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018;
- pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyrën e lëvizjeve të kapitalit për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyrën e flukseve të parasë të përgatitur për vitin e mbyllur në atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe çështje të tjera.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin *Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare* në raportin tonë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK"). Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përbëhen nga skedulet suplementare të cilat përfshijnë aftësinë paguese dhe aktivet në mbulim të rezervave teknike.

Opinioni ynë për pasqyrat financiare nuk i përfshin informacionet e tjera dhe ne nuk japim asnjë lloj sigurie në lidhje me to.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionet e tjera dhe të konsiderojmë nëse ka ndonjë mospërputhje materiale të këtij informacione me pasqyrat financiare ose informacionin e marrë prej nesh gjatë auditimit. Nëse bazuar në punën e kryer prej nesh në lidhje me informacionet e tjera të marra para datës së këtij raporti, ne arrijmë në përfundimin se ka një gabim material në këto informacione të tjera, e raportojmë këtë si gjetje. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtimi i shoqërisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollet e brendshme, të cilat drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likuidojë shoqërinë apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen e shoqërisë janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një gabim material. Gabimet mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimit material në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një gabim material si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një gabim si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- sigurojmë kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm të auditimit, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë.
- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga drejtimi.
- arrijmë në përfundime mbi përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga drejtimi dhe bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri të materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së shoqërisë.

Raporti i Audituesit të Pavarur (vazhdim)

- vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që sigurohet paraqitja e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e shoqërisë, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontrolleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.
4 prill 2019
Tiranë, Shqipëri

Jonid Lamllari
Auditues Ligjor

Intersig Vienna Insurance Group sh.a
Pasqyra e pozicionit financiar
(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
AKTIVE			
Aktive të trupëzuara dhe të patrupëzuara	10	76,136	50,574
Aktive të mbajtuara për investime	11	189,045	198,995
Aksione në shoqëri të lidhura	12	12,566	9,316
Aktive të risigurimit	13	684,775	723,373
Letra me vlerë me kosto të amortizuar	14	864,673	706,284
Depozita me afat me bankat	15	733,958	777,638
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	17	186,901	197,895
Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimeve dhe të tjera	18	85,759	112,978
Aktive të tjera	16	76,468	67,986
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to	19	54,627	85,935
TOTALI AKTIVEVE		**2,964,908**	**2,930,974**
KAPITALI			
Kapitali aksionar	20	417,471	417,471
Rezerva e rrezikut të sigurimit	20	41,747	41,747
Fitime të mbartura		142,169	66,948
TOTALI I KAPITALIT		**601,387**	**526,166**
DETYRIMET			
Borxh i varur	21	-	66,562
Detyrime për kontratat e sigurimit	22	886,915	805,235
Rezerva për primet e pafituara	23	776,051	805,829
Depozita e risiguruesit	24	569,033	551,970
Detyrime tatimore dhe të ngjashme	25	24,354	31,216
Tatim fitimi i pagueshëm		3,287	8,944
Detyrime nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	26	103,881	135,052
TOTALI I DETYRIMEVE		**2,363,521**	**2,404,808**
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		**2,964,908**	**2,930,974**

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i shoqërisë më datë 1 prill 2019 dhe nënshkruar në emër të tyre nga:

Gentian Sulaj
Drejtor i përgjithshëm

DREJTORIA E PËRGJITHSHME
INTERSIG
VIENNA INSURANCE GROUP
NIPT: K12201002T

Ilir Elmazi
Drejtor Finance

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 43 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Intersig Vienna Insurance Group sh.a
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse
(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënime	2018	2017
Prime të shkruara bruto	27	1,678,897	1,666,590
Prime të ceduara të risiguruesit	28	(781,176)	(846,034)
Ndryshimi në rezervën për primet e pafituara bruto	23	29,779	(71,056)
Ndryshimi në rezervën e risiguruesit për primet e pafituara	23	(47,955)	88,030
Prime të fituara neto		**879,545**	**837,530**
Të ardhura të tjera	29	12,611	6,744
Të ardhura neto		**892,156**	**844,274**
Ndryshimi në rezervën e dëmeve bruto	22	(81,680)	83,110
Ndryshimi në rezervën e dëmeve të risiguruesit	22	9,356	(97,331)
Dëme të paguara bruto	22	(601,445)	(760,651)
Dëme të paguara nga risiguruesi	22	205,132	347,382
Dëme të sigurimit, neto		(468,637)	(427,490)
Shpenzimet e marrjes në sigurim	30	(471,355)	(461,355)
Shpenzime administrative	31	(289,160)	(259,809)
Të ardhura nga komisionet e risigurimit	32	459,265	405,006
Zhvlerësimi për llogaritë e arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimeve	18	(6,000)	(8,816)
Shpenzime të tjera të sigurimit	33	(33,513)	(25,640)
Fitimi operativ		**82,745**	**66,170**
Të ardhura nga interesi	34	54,126	46,213
Shpenzime financiare		(15,221)	(17,375)
Të ardhura nga kurset e këmbimit, neto	35	(28,342)	(11,045)
Të ardhura financiare, neto		10,563	17,793
Fitimi para tatimit		**93,308**	**83,963**
Tatim mbi fitimin	36	(18,087)	(17,015)
Fitimi i vitit		**75,221**	**66,948**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin, neto nga taksat		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		**75,221**	**66,948**

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 43 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Intersig Vienna Insurance Group sh.a
Pasqyra e ndryshimeve në kapital

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Kapitali themeltar	Rezerva	Humbje të mbartura	Totali
Gjendja më 1 janar 2017	**1,228,000**	**53,265**	**(822,047)**	**459,218**
Fitimi i vitit	-	-	66,948	66,948
Të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin, neto nga taksat	-	-	-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	**66,948**	**66,948**
Zvogëlimi i kapitalit për mbulimin e humbjeve të mbartura	(810,529)	(11,518)	822,047	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	**417,471**	**41,747**	**66,948**	**526,166**
Fitimi i vitit	-	-	75,221	75,221
Të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin, neto nga taksat	-	-	-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	**75,221**	**75,221**
Zvogëlimi i kapitalit për mbulimin e humbjeve të mbartura	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	**417,471**	**41,747**	**142,169**	**601,387**

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 43 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Shënime	2018	2017
Fitimi para tatim fitimit		**93,308**	**83,963**
Fluksi i parasë nga aktivitetet e shfrytëzimit			
Rregullime për:			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	10,31	26,575	23,191
Nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara		-	349
Zhvlerësimi për llogaritë e arkëtushme nga aktiviteti i sigurimit	18	4,717	8,816
Iinvestimi në shoqëritë e lidhura		-	(1,342)
Të ardhura nga interest e përllogaritura		-	(1,994)
Fluksi i parasë nga aktivitetet e shfrytëzimit para ndryshimeve ne aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit		**124,600**	**112,983**
Ndryshime në aktive të risigurimit		38,598	9,300
Ndryshime në shpenzimet e shtyra te marrjes ne sigurim		10,994	(25,468)
Ndryshime në llogari pagueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera		22,502	(45,185)
Ndryshime në aktive të tjera		(8,482)	10,977
Ndryshime në detyrime për kontratat e sigurimit		81,680	(83,109)
Ndryshime në rezervën për primet e pafituara		(29,778)	71,056
Ndryshime në depoziten e risiguruesit		17,063	76,373
Ndryshime në detyrime nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera		(31,171)	71,838
Ndryshime në detyrime tatimore dhe të ngjashme		(6,862)	4,926
Flukset monetare të gjeneruara nga aktivitetet e shfrytëzimit		**219,145**	**203,691**
Tatim mbi fitimin i paguar		(23,744)	(8,640)
Flukset monetare neto nga aktivitetet e shfytëzimit		**195,401**	**195,051**
Flukset monetare nga aktivitetet investuese			
Blerje aktivesh të trupëzuara dhe të patrupëzuara	10	(42,188)	(20,020)
Blerje e letrave me vlerë me kosto të amortizuar		(161,639)	(121,834)
Rënie në depozitat me afat		43,680	24,116
Flukset monetare neto të përdorura në aktivitetet investuese		**(160,147)**	**(117,736)**
Flukset monetare nga aktivitetet finacuese			
Shlyerje e borxhit të varur	21	**(66,562)**	**(68,845)**
Flukset monetare neto të përdorura në aktivitetet finacuese			
(Ulje)/rritja neto në mjetet monetare dhe ekuivalentet me to		**(31,308)**	**8,470**
Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to në fillim të vitit		**85,935**	**77,465**
Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to në fund të vitit	19	**54,627**	**85,935**

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 43 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacione të përgjithshme

Këto pasqyra financiare janë përgatitur për Intersig Vienna Insurance Group Sh.a., ("Shoqëria") në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

"Intersig Vienna Insurance Group" sh.a ("Shoqëria" ose "Intersig") u krijua më 19 qershor 2001 si një shoqëri sigurimesh e vendosur në Shqipëri dhe u licensua nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (në vijim "AMF" ose "Rregullatori" ose "Autoriteti") më 13 shtator 2001.

Shoqëria mëmë është Vienna Insurance Group Ag Wiener Versicherung Gruppe, Vienna, Austria e cila zotëron 89.98% të aksioneve. Pala kontrolluese përfundimtare e grupit është Wiener Städtische Wechselseitiger Versicherungsverein - Vermögensverwaltung - Vienna Insurance Group, Vjenë, Austri.

Aktivitetet e shoqerisë aktualisht janë subjekt i ligjeve nr. 9901, datë 14 prill 2008 "Për sipërmarrësit dhe shoqëritë tregtare" dhe nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit ", hyre në fuqi më 4 korrik 2014 ("Ligji i Sigurimit"). Enti rregullator i tregut të sigurimeve është "AMF".

Aktiviteti kryesor: Aktivitetet kryesore të biznesit përfshijnë ofrimin e shpërbimeve të sigurimit për mjetet motorike, pasuritë, shëndetin dhe një sërë sigurimesh të tjera të jo-jetës.

Adresa e regjistruar dhe vendi i biznesit: Zyrat qendrore të Shoqërisë ndodhen në Rr. Ismail Qemali, Samos Tower/kati II, Ish Bllok Tiranë, Shqipëri. Shoqëria ka 138 punonjës më 31 dhjetor 2018 (2017: 140).

Bordi mbikëqyrës dhe bordi drejtues gjatë 2018 dhe deri në datën e aprovimit të pasqyrave financiare rezulton si më poshtë:

Bordi Mbikëqyrës	***Pozicioni***	***Bordi drejtues***	***Pozicioni***
Z. Peter Hoefinger	Kryetar	Z. Gentian Sulaj	Drejtor i Përgjithshëm
Z. Christoph Rath	Zv.Kryetar	Znj. Fitnete Sulaj	Anëtar Bordi
Z. Michael Hack	Anëtar	Z. Fatmir Berdica	Anëtar Bordi

2. Bazat e kontabilitetit

Deklarata e përputhshmërisë Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombetare të Raportimit Financiar ("SNRF") sipas parimit të kostos historike. Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura, përveç nëse është shprehur ndryshe (shiko shënimet 3 dhe 4 për zbatimin e standardeve të reja ose të rishikuara dhe interpretimin e standardeve të reja kontabël të zbatuara nga shoqëria.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e vlerësimeve të caktuara kontabël. Ajo gjithashtu kërkon që drejtimi të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë. Fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë gjykimi ose kompleksiteti, ose fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare janë të detajuara në shënimin 6.

Monedha funksionale dhe e paraqitjes Këto pasyqra financiare janë paraqitur në Lek Shqiptar (Lekë), të rrumbullakosura në mijë Lekë. Lek është monedha funksionale e shoqërisë, monedha kryesore në mjedisin ekonomik ku ajo kryen aktivitetin e saj.

3. Zbatimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara

Standardet dhe interpretimet e reja të mëposhtme u bënë efektive për shoqërinë më 1 janar 2018:

Zbatimi i SNRF 9 Instrumentet Financiare me SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve - Ndryshimet në SNRF 4 (të publikuara më 12 Shtator 2016 dhe efektive, varësisht nga qasja, për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018 për subjektet që zgjedhin të zbatojnë opsionin e përjashtimit të përkohshëm; kur njësia ekonomike së pari zbaton SNRF 9 për njësitë ekonomike që zgjedhin të zbatojnë metodën e mbivendosjes). Ndryshimet adresojnë shqetësimet që dalin nga zbatimi i standardeve të reja financiare, SNRF 9, përpara zbatimit të standardit që BNSK po zhvillon për të zëvendësuar SNRF 4. Këto shqetësime përfshijnë paqëndrueshmërinë e përkohshme në rezultatet e raportuara. Ndryshimet paraqesin dy qasje: një qasje mbivendosje dhe një qasje e shtyrjes. Standardi i ndryshuar do t'i japë të gjitha shoqërive që lëshojnë kontrata sigurimi mundësinë për të njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, në vend të fitimit ose humbjes, paqëndrueshmërinë që mund të lindë kur të zbatohet SNRF 9 përpara se të lëshohet kontrata e re e sigurimit. Përveç kësaj, standardi i ndryshuar do t'u japë ndërmarrjeve, aktivitetet e të cilave kryesisht lidhen me sigurimin e përjashtimit opsional të përkohshëm nga zbatimi i SNRF 9 deri në vitin 2021. Subjektet që shtyjnë zbatimin e SNRF 9 do të vazhdojnë të zbatojnë standardin ekzistues për instrumentet financiare SNK 39. Ndryshimet në SNRF 4 plotësojnë opsionet ekzistuese në standard që tashmë mund të përdoren për të trajtuar luhatshmërinë e përkohshme. Shoqëria vendosi që të shtyjë zbatimin e IFRS 9 dhe të plotësojë kushtet përkatëse kualifikuese sepse: (i) detyrimet e saj të lidhura me kontratat e sigurimit janë më shumë se 95% e detyrimeve totale më 31 dhjetor 2018 dhe (ii) nuk ka pasur ndryshime të mëvonshme të rëndësishme në aktivitetin e shoqërisë. Shoqëria pret të përdorë SNRF 9 duke filluar nga viti 2021 dhe nuk e ka zbatuar atë në asnjë fazë më të hershme.

SNRF 15, Të ardhurat nga kontratat me klintët (publikuar më 28 maj 2014 dhe efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018). Standardi i ri prezanton parimin kryesor që të ardhurat duhet të njihen kur mallrat ose shërbimet i transferohen klientit, me çmimin e transaksionit. Çdo mall ose shërbim i lidhur që është i dallueshëm duhet të njihet veçmas, dhe çdo zbritje ose skonto me çmimin e kontratës në përgjithësi duhet të ndahet për elementët e veçantë. Kur shuma ndryshon për çfarëdo arsye, shuma minimale duhet të njihet nëse nuk ka një rrezik të madh për anulimin. Kostot e shkaktuara për të siguruar kontratat me klientët duhet të kapitalizohen dhe të amortizohen gjatë periudhës kur konsumohen përfitimet nga kontrata.

Ndryshimet në SNRF 15, Të ardhurat nga kontratat me klientët (publikuar më 12 prill 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018). Ndryshimet nuk ndryshojnë parimet themelore të Standardit, por sqarojnë se si duhet zbatuar këto parime. Ndryshimet sqarojnë se si të identifikojnë një detyrim (premtimi për të transferuar një të mirë ose një shërbim për një klient) në një kontratë; si të përcaktohet nëse një shoqëri është kryesori (ofruesi i një të mirë ose shërbimi) ose një agjent (përgjegjës për rregullimin e të mirave ose shërbimeve që duhet të ofrohen); dhe si të përcaktohet nëse të ardhurat nga dhënia e licencës duhet të njihen në një moment ose me kalimin e kohës. Përveç sqarimeve, ndryshimet përfshijnë dy lehtësime shtesë për të zvogëluar koston dhe kompleksitetin për një shoqëri kur ajo e zbaton në fillim standardin e ri. Shoqeria nuk ka pasur ndikim material pas zbatimit të standardit të ri. Klientët me kontrata të ndryshme nga kontratat e sigurimit janë të kufizuar dhe njohja e të ardhurave nuk ndryshon sipas standardit të ri.

KIRFN 22 - Transaksionet në valutë të huaj dhe konsiderata paraprake (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018). Interpretimi adreson mënyrën e përcaktimit të datës së transaksionit me qëllim të përcaktimit të kursit të këmbimit për t'u përdorur në njohjen fillestare të aktivit, shpenzimeve ose të ardhurave (ose një pjese të tij) lidhur me mosnjohjen e një aktivi jo-monetar ose detyrimi jo-monetar që rrjedh nga një paradhënie paraprake në një monedhë të huaj. Sipas SNK 21, data e transaksionit me qëllim të përcaktimit të kursit të këmbimit për tu përdorur në njohjen fillestare të aktivit, shpenzimeve ose të ardhurave (ose një pjese të tyre) është data në të cilën një njësi ekonomike fillimisht njeh aktivin jo-monetar ose detyrim jo-monetar që rrjedh nga shuma paraprake. Nëse ka pagesa të shumta ose faturat parapagimi, atëherë njësia ekonomike duhet të përcaktojë datën e transaksionit për çdo pagesë ose marrje parapagimi. KIRFN 22 zbatohet vetëm në rrethanat në të cilat një njësi ekonomike njeh një aktiv jo-monetar ose detyrim jo-monetar që rrjedh nga një shqyrtim paraprak. KIRFN 22 nuk ofron udhëzime zbatimi për përcaktimin e zërave monetarë dhe jo monetarë. Një pagesë paradhënie ose marrje në përgjithësi shkakton njohjen e një aktivi jo-monetar ose të detyrimit jo-monetar, megjithatë, ai gjithashtu mund të krijojë një aktiv ose detyrim monetar.

3. Zbatimi i i standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara (vazhdim)

Një njësi ekonomike mund të ketë nevojë të zbatojë gjykimin për të përcaktuar nëse një element është monetar ose jo-monetar. Shoqëria aktualisht po vlerëson ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.

Ndryshimet në SNRF 2, pagesa e bazuar në aksione (publikuar më 20 qershor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018). Ndryshimet nënkuptojnë që kushtet e kushtëzimit të performancës jo të tregut do të ndikojnë në matjen e transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione të rregulluara në mjete monetare në të njëjtën mënyrë si shpërblimet e shlyerjes së kapitalit. Ndryshimet sqarojnë gjithashtu klasifikimin e një transaksioni me një tipar të shlyerjes neto në të cilën njësia ekonomike mban një pjesë të specifikuar të instrumentave të kapitalit neto, të cilat përndryshe do t'u jepeshin palës tjetër pas ushtrimit (ose dhënies), në këmbim për shlyerjen e detyrimit tatimor të palës tjetër që shoqërohet me pagesën e bazuar në aksione. Marrëveshjet e tilla do të klasifikohen si kapital i rregulluar në tërësinë e tyre. Në përfundim, ndryshimet sqarojnë gjithashtu kontabilitetin për pagesat e bazuara në aksione të rregulluara në mjete monetare të cilat janë modifikuar për tu shlyer në kapital, si vijon (a) pagesa e bazuar në aksione matet duke iu referuar vlerës së drejtë të instrumentit të kapitalit të dhënë në datën e modifikimit; (b) pasivi është çregjistruar pas modifikimit, (c) pagesa e bazuar në aksione të rregulluar me kapital, njihet deri në masën që shërbimet janë kryer deri në datën e modifikimit dhe (d) diferenca midis vlerës kontabël të detyrimit në datën e modifikimit dhe shuma e njohur në kapital në të njëjtën datë, regjistrohet menjëherë në fitim ose humbje. Shoqëria nuk ka pagesa të bazuara në aksione prandaj këto ndryshime nuk kanë efekt në pasqyrat e saj financiare.

Transferimet e pronës për investim - Ndryshimet në SNK 40 (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018). Ndryshimet sqarojnë kërkesat për transferimet në ose nga prona për investim në lidhje me pronat në ndërtim e sipër. Para ndryshimeve, nuk kishte udhëzime specifike për transferimet e pronave për investim në ndërtim e sipër në SNK 40. Ndryshimi sqaron se nuk kishte ndërmend të ndalonte transfertat e një prone në ndërtim ose zhvillim, të klasifikuar më parë si inventar, tek prona për investim kur ka një ndryshim të dukshëm në përdorim. SNK 40 është ndryshuar për të përforcuar parimin e transfertave në ose jashtë pronës së investimit në SNK 40 për të specifikuar që një transferim në ose jashtë pronës së investimit duhet të bëhet vetëm kur ka pasur një ndryshim në përdorimin e pronës; dhe një ndryshim i tillë në përdorim do të përfshinte një vlerësim nëse prona kualifikohet si një pronë për investim. Një ndryshim i tillë në përdorim duhet të mbështetet me prova. Shoqëria aktualisht po vlerëson ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.

Përmirësimet vjetore të SNRF 2014-2016 - Ndryshimet në SNRF 1 të SNK 28 (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018). SNRF 1 u ndryshua dhe disa nga përjashtimet afatshkurtra nga SNRF-të në lidhje me dhënien e informacioneve shpjeguese rreth instrumenteve financiare, përfitimeve të punonjësve dhe njësive të investimit u hoqën, pasi ato përjashtime afatshkurtra e kanë shërbyer qëllimin e synuar. Ndryshimet në SNK 28 sqarojnë se një njësi ekonomike ka një zgjedhje në bazë investimi për matjen e investitorëve me vlerë të drejtë në përputhje me SNK 28 nga një organizatë e kapitaleve sipërmarrëse, ose një fond të përbashkët, njësi besimi ose njësi të ngjashme përfshirë fondet e sigurimeve të lidhura me investimet. Përveç kësaj, një njësi ekonomike që nuk është një njësi ekonomike investuese mund të ketë një shoqëri ose sipërmarrje të përbashkët që është një njësi investimi. SNK 28 lejon një njësi ekonomike të tillë që të mbajë matjet e vlerës së drejtë të përdorura nga ai njësi ekonomike investuese ose sipërmarrje e përbashkët kur zbaton metodën e kapitalit neto. Ndryshimet sqarojnë se kjo zgjedhje është gjithashtu e disponueshme në bazë investimi. Shoqëria aktualisht po vlerëson ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.

4. Standardet e reja kontabël

Janë nxjerrë disa standarde dhe interpretime të reja që janë të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019 ose më vonë dhe të cilat shoqëria nuk ka miratuar në mënyrë të hershme.

SNRF 9 "Instrumentet financiare" (i ndryshuar në korrik 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018). Karakteristikat kryesore të standardit të ri janë:

- Asetet financiare kërkohen të klasifikohen në tre kategori matëse: ato që duhet të maten më pas me koston e amortizuar, ato që maten më pas me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI) dhe ato që maten më pas me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVPL).
- Klasifikimi për instrumentet e borxhit udhëhiqet nga modeli i biznesit i njësisë ekonomike për menaxhimin e aktiveve financiare dhe nëse flukset monetare kontraktuale përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit (SPPI). Nëse një instrument borxhi mbahet për tu mbledhur, ai mund të mbartet me koston e amortizuar nëse plotëson edhe kërkesat e SPPI. Instrumentet e borxhit që plotësojnë kërkesat e SPPI që mbahen në një portofol ku një njësia ekonomike zotëron të mbledhë flukse monetare të aktiveve dhe shet active, mund të klasifikohet si FVOCI. Aktivet financiare që nuk përmbajnë flukse monetare që janë SPPI duhet të maten në FVPL (për shembull, derivatet). Derivatet e përfshirë nuk janë më të ndarë nga aktivet financiare, por do të përfshihen në vlerësimin e kushteve të SPPI.
- Investimet në instrumentet e kapitalit maten gjithmonë me vlerën e drejtë. Megjithatë, menaxhimi mund të bëjë një zgjedhje të pakthyeshme për të paraqitur ndryshimet në vlerën e drejtë në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, me kusht që instrumenti të mos mbahet për tregtim. Nëse instrumenti i kapitalit është mbajtur për tregtim, ndryshimet në vlerën e drejtë paraqiten në fitim ose humbje.
- Shumica e kërkesave në SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare kanë mbetur të pandryshuara në SNRF 9. Ndryshimi kryesor është që një njësi ekonomike do të kërkohet të paraqesë efektet e ndryshimeve në rrezikun e vet të kredisë për detyrimet financiare të përcaktuara me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në të ardhura të tjera përmbledhëse.
- SNRF 9 paraqet një model të ri për njohjen e humbjeve nga zhvlerësimi - modeli i pritshëm i humbjeve të kreditit (ECL). Ekziston një qasje "me tre faza" e cila bazohet në ndryshimin në cilësinë e kredisë të aktiveve financiare që nga njohja fillestare. Në praktikë, rregullat e reja nënkuptojnë që njësitë ekonomike do të duhet të regjistrojnë një humbje të menjëhershme të barabartë me ECL 12 mujore për njohjen fillestare të aktiveve financiare që nuk janë të dëmtuara nga kredia (ose ECL gjatë jetës për të arkëtueshmet tregtare). Aty ku ka pasur një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë, zhvlerësimi matet duke përdorur ECL-në e përjetshme në vend të ECL-së 12-mujore. Modeli përfshin thjeshtimet operacionale për qiranë dhe llogaritë e arkëtueshme tregtare.
- Kërkesat mbrojtëse të kontabilitetit u ndryshuan për të harmonizuar kontabilitetin më ngushtë me menaxhimin e riskut. Standardi i ofron njësisë ekonomike një zgjedhje të politikës kontabël ndërmjet zbatimit të kërkesave mbrojtëse të kontabilitetit të SNRF 9 dhe vazhdimit të zbatimit të SNK 39 në të gjitha mbrojtjet sepse standardi aktualisht nuk trajton kontabilizimin për mbrojtje makro.

Shoqëria ka zgjedhur të zbatojë opsionin e përjashtimit të përkohshëm dhe pret ta zbatojë IFRS 9 duke filluar nga viti 2021.

SNRF 16 "Qiratë" (publikuar më 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019). Standardi i ri përcakton parimet për njohjen, matjen, prezantimin dhe paraqitjen e qirasë. Të gjitha qiratë rezultojnë në faktin që qiramarrësi ka të drejtën e përdorimit të një aktivi në fillim të qirasë dhe, nëse pagesat e qirasë bëhen me kalimin e kohës, gjithashtu merr financime. Prandaj, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qerave qoftë kjo si qera operative ose qira financiare siç kërkohet nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, prezanton një model të vetëm të kontabilitetit të qiramarrësit. Qiramarrësit do të kërkohet të njohin: (a) aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me një afat më të gjatë se 12 muaj, përveç nëse aktivi nënligjor është me vlerë të vogël; dhe (b) zhvlerësimin e aktiveve të qirasë veç e veç nga interesi për detyrimet e qirasë në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhura të tjera përmbledhëse. SNRF 16 në thelb përcjell kërkesat e kontabilitetit të qiradhënësit në SNK 17. Prandaj, një qiradhënës vazhdon të klasifikojë qiratë e tij si qera operative ose qira financiare dhe të llogarisë këto dy lloje të qirasë ndryshe. Shoqëria vendosi që do të zbatojë standardin e ri nga data e tij e detyrueshme e zbatimit 1 janar 2019 duke përdorur metodën retrospektive të modifikuar, pa riparaqitur shifrat krahasuese.

4. Standartet e reja kontabël (vazhdim)

SNRF 17 "Kontratat e sigurimeve" (publikuar më 18 maj 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021). SNRF 17 zëvendëson SNRF 4, i cili i ka dhënë mundësi shoqërive që të mbajnë kontabilitetin për kontratat e sigurimit duke përdorur praktikat ekzistuese. Si pasojë, ishte e vështirë për investitorët të krahasojnë performancën financiare të shoqërive të ngjashme të sigurimit. SNRF 17 është një standard i vetëm i bazuar në parime për të llogaritur të gjitha llojet e kontratave të sigurimit, duke përfshirë kontratat e risigurimit që një sigurues mban. Standardi kërkon njohjen dhe matjen e grupeve të kontratave të sigurimit në: (i) një vlerë aktuale të rregulluar nga risku i flukseve të ardhshme të parasë (flukset monetare të përmbushjes) që përfshijnë të gjithë informacionin në dispozicion për flukset e mjeteve monetare të përmbushjes në një mënyrë që është në përputhje me informacionin e tregut të vëzhgueshëm; plus (nëse kjo vlerë është një detyrim) ose minus (nëse kjo vlerë është një aktiv) (ii) një shumë që përfaqëson fitimin e pafituar në grupin e kontratave (marzhi i shërbimit kontraktual). Siguruesit do të njohin fitimin nga një grup i kontratave të sigurimit gjatë periudhës që ata ofrojnë mbulim sigurimi, dhe pasi ato lirohen nga rreziku. Nëse një grup i kontratave është ose bëhet humbje, një njësi ekonomike do të njohë menjëherë humbjen. Shoqëria aktualisht po vlerëson ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.

KIRFN 23 "Pasiguria mbi trajtimin e taksave mbi të ardhurat" (publikuar më 7 qershor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019). SNK 12 specifikon mënyrën e llogaritjes së tatimit aktual dhe të shtyrë, por jo si të pasqyrojë efektet e pasigurisë. Interpretimi sqaron se si të zbatohen kërkesat e njohjes dhe të matjes në SNK 12 kur ka pasiguri mbi trajtimet e tatimit mbi të ardhurat. Një njësi ekonomike duhet të përcaktojë nëse duhet të konsiderojë çdo trajtim të pasigurt tatimor veç e veç ose së bashku me një ose më shumë trajtime të tjera të pasigurta tatimore bazuar në atë metodë që parashikon sa më mirë zgjidhjen e pasigurisë. Një njësi ekonomike duhet të supozojë se një autoritet tatimor do të shqyrtojë shumat që ka të drejtë të shqyrtojë dhe të ketë njohuri të plotë për të gjitha informacionet e lidhura me to gjatë kryerjes së këtyre kontrolleve. Nëse një njësi ekonomike arrin në përfundim se nuk është e mundur që autoriteti tatimor të pranojë një trajtim të pasigurt tatimor, efekti i pasigurisë do të pasqyrohet në përcaktimin e fitimit ose humbjes së tatueshme, bazës tatimore, humbjeve tatimore të papërdorura, kredive të papërdorura tatimore ose normave tatimore duke përdorur shumën më të mundshme ose vlerën e pritur, në varësi të metodës që njësia ekonomike pret të parashikojë më mirë zgjidhjen e pasigurisë. Një njësi ekonomike do të pasqyrojë efektin e një ndryshimi në fakte dhe rrethana ose në informacione të reja që ndikojnë në gjykimet ose vlerësimet e kërkuara nga interpretimi si një ndryshim në vlerësimin kontabël. Shembujt e ndryshimeve në fakte dhe rrethana ose informacione të reja që mund të rezultojnë në rivlerësimin e një gjykimi apo vlerësimi përfshijnë, por nuk kufizohen në, ekzaminimet ose veprimet e një autoriteti tatimor, ndryshimet në rregullat e vendosura nga një autoritet tatimor ose skadimi i një e drejta e autoritetit tatimor për të shqyrtuar ose rishqyrtuar një trajtim tatimor. Mungesa e një marrëveshjeje ose mosmarrëveshjeje nga një autoritet tatimor me një trajtim tatimor, të veçuar, nuk ka të ngjarë të përbëjë një ndryshim në fakte dhe rrethana apo informata të reja që ndikojnë në gjykimet dhe vlerësimet e kërkuara nga interpretimi. Shoqëria aktualisht po vlerëson ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.

Shitja ose dhurimi i aktiveve midis një Investitori dhe Bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët - Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 (të publikuara më 11 Shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas një date që do të përcaktohet nga BSNK). Këto ndryshime adresojnë një mospërputhje midis kërkesave të SNRF 10 dhe atyre në SNK 28 në trajtimin e shitjes ose të kontributit të aktiveve ndërmjet një investitori dhe shoqërisë së tij ose sipërmarrjes së përbashkët. Pasoja kryesore e ndryshimeve është se një fitim ose humbje e plotë njihet kur një transaksion përfshin një biznes. Një fitim ose humbje e pjesshme njihet kur një transaksion përfshin aktivet që nuk përbëjnë një biznes, edhe nëse këto mjete mbahen nga një filial. Shoqëria aktualisht po vlerëson ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.

Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ - Ndryshimet në SNRF 9 (publikuar më 12 tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019). Ndryshimet mundësojnë matjen me koston e amortizuar të kredive të caktuara dhe letrave me vlerë të borxhit që mund të parapaguhen me një shumë nën koston e amortizuar, për shembull me vlerën e drejtë ose në një shumë që përfshin një kompensim të arsyeshëm të pagueshëm ndaj huamarrësit të barabartë me vlerën aktuale të një efekti rritja e normës së interesit të tregut gjatë jetës së mbetur të instrumentit. Përveç kësaj, teksti i shtuar në bazë të standardeve për përfundim rikonfirmon udhëzimet ekzistuese në SNRF 9 se modifikimet ose shkëmbimet e disa detyrimeve financiare të matura me koston e amortizuar që nuk rezultojnë në çregjistrim do të rezultojnë në një fitim ose humbje në fitim ose humbje. Subjektet raportuese kështu në shumicën e rasteve nuk do të jenë në gjendje të rishikojnë normën efektive të

4. Standartet e reja kontabël (vazhdim)

interesit për jetën e mbetur të huasë në mënyrë që të shmanget një ndikim në fitim ose humbje pas modifikimit të kredisë. Shoqëria aktualisht po vlerëson ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.

Interesat afatgjata në shoqëritë dhe sipërmarrjet e përbashkëta - Ndryshimet në SNK 28 (publikuar më 12 Tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2019). Ndryshimet sqarojnë që njësitë raportuese duhet të zbatojnë SNRF 9 për huatë afatgjata, aksionet preferenciale dhe instrumente të ngjashme që janë pjesë e një investimi neto në një metodë të kapitalit neto të investuar para se të mund ta zvogëlojnë këtë vlerë bartëse me një pjesë të humbjes së të investuarit që tejkalon shumën e interesit të investitorit në aksionet e zakonshme. Shoqëria aktualisht po vlerëson ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.

Përmirësimet vjetore të SNRF-ve 2015-2017 - Ndryshimet në SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23 (publikuar më 12 Dhjetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2019). Ndryshimet ndikojnë në katër standarde. Në SNRF 3 u sqarua se një blerës duhet të rimendojë interesin e tij të mbajtur më parë në një operacion të përbashkët kur të marrë kontrollin e biznesit. Në anën tjetër, SNRF 11 tani shpjegon në mënyrë eksplicite se investitori nuk duhet të rimarrë peshën e interesit të mbajtur më parë kur të marrë kontrollin e përbashkët të një operacioni të përbashkët, ngjashëm me kërkesat ekzistuese kur një pjesëmarrës bëhet një sipërmarrje e përbashkët dhe anasjelltas. SNK 12 i ndryshuar shpjegon se një njësi ekonomike njeh të gjitha pasojat e tatimit mbi të ardhurat e dividendëve në rastet kur ka njohur transaksionet ose ngjarjet që gjenerojnë fitimet e shpërndara, p.sh. në fitim ose humbje ose në të ardhura të tjera përmbledhëse. Tani është e qartë se kjo kërkesë zbatohet në të gjitha rrethanat përderisa pagesat për instrumentet financiare të klasifikuara si kapital janë shpërndarjet e fitimeve dhe jo vetëm në rastet kur pasojat tatimore janë rezultat i normave të ndryshme tatimore për fitimet e shpërndara dhe të pashpërndara. SNK 23 i rishikuar tani përfshin udhëzime të qarta se huamarrjet e fituara posaçërisht për financimin e një aktivi të specifikuar janë përjashtuar nga grupi i kostove të huasë të përgjithshme të pranueshme për kapitalizim vetëm derisa aktivi specifik është në thelb i plotë. Shoqëria aktualisht po vlerëson ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.

Ndryshimet në SNK 19 "Ndryshimet, shkurtimet ose shlyerja e planit" (publikuar më 7 Shkurt 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2019). Ndryshimet qartësojnë përllogartjen e shpenzimeve për pensionin në mometin kur ndodhin ndryshime në planin e pensionit me përfitime të përcaktuara. Kur një ndryshim ndodh: përmirësim, shkurtim ose shlyerje; SNK 19 kërkon që të ri-llogaritet përfitimi I përcaktuar neto si detyrim ose si asset. Përmirësimet ne standart kërkojnë përdorimin e supozimeve të përditësuara nga kjo ri-llogaritje në mënyrë që të përcaktohet kosto aktuale e shërbimit dhe intersi neto për pjesën e mbetur të periudhës raportuese pas ndryshimit të planit. Para se të bëhej ky përmirësim në standart, SNK 19 nuk përcaktonte llogaritjen e këtyre shpenzimeve për periudhën pasi bëhej ndonjë ndryshim në plan. Duke e bërë një domosdoshmëri përdorimin e supozimeve të përditësuara, standarti I ndryshuar pritet që të japi një informacion të dobishëm përdoruesve të pasqyrave financiare.

Shoqëria aktualisht po vlerëson ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.

Ndryshimet në kuadrin konceptual për raportim financiar (publikuar më 29 Mars 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020). Kuadri konceptual I rishikuar përfshin një kapitull të ri mbi llogaritjen; udhëzime për performacën e raportimit financiar; përkufizime dhe udhëzime të përmirësuara në veçanti përkufizimin e detyrimeve; dhe sqarimi në lidhje me fusha të rëndësishme si psh: roli I menaxhimit, matja dhe reduktimi I pasigurisë në raportimin financiar.

Përkufizimi i një biznesi – Ndryshimet në SNRF 3 (publikuar më 22 Tetor dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020). Ndryshimet rishikojnë përkufizimin e një biznesi. Biznesi duhet të ketë inpute dhe procese të vazhdueshme, ku së bashku të kontribuojnë në mënyrë që të krijohet output. Udhëzimi I ri ofron një kornizë për të vlerësuar kur një input dhe një proces substancial janë të pranishëm, duke përfshirë edhe shoqëritë në fazat e hershme që nuk kanë gjeneruar ende outpute. Një forcë punëtore e organizuar duhet të jetë e pranishme si kusht për klasifikimin si biznes nëqoftëse nuk ka ende outpute. Përkufizimi i termit "output" është ngushtuar dhe fokusuar në shërbimet dhe mallrat që i ofrohen konsumatorëve, duke gjeneruar të ardhura nga investimet dhe të ardhura të tjera dhe përjashton të ardhurat në që vijnë nga reduktimi i kostove dhe të ardhurat nga përfitimet e tjera ekonomike. Gjithashtu nuk është më e nevojshme të vlerësohet nëse

4. Standartet e reja kontabël (vazhdim)

pjesëmarrësit e tregut janë në gjendje të zëvendësojnë elementët e humbur ose të integrojnë aktivitetet dhe asetet e fituara. Një njësi ekonomike mund të zbatojë një 'test përqendrimi'. Asetet e blera nuk do të mund të përfaqësonin një biznes nëqoftëse e gjithë vlera e drejtë e aseteve bruto të blera është e përqëndruar në një aset të vetëm (ose në disa asete të ngjashme). Ndryshimet janë të mundshme dhe shoqëria do t'i zbatojë ato dhe do të vlerësojë ndikimin e tyre duke filluar nga data 1 Janar 2020.

Përkufizimi i materialitetit – Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8 (publikuar më 31 Tetor 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020). Ndryshimet sqarojnë përkufizimin e materialit dhe si duhet zbatuar duke përfshirë në udhëzimin e përcaktimit që deri më tani ka paraqitur diku tjetër në SNRF. Përveç kësaj, shpjegimet që shoqërojnë përkufizimin janë përmirësuar. Së fundmi, ndryshimet sigurojnë që përkufizimi i materialit të jetë i qëndrueshëm në të gjitha standardet e SNRF-ve. Informacioni është material nëse mospërfshirja, anashkalimi ose fshehja e tij pritet që të influencojë vendimet e marra duke u bazuar në këto pasqyra financiare nga përdoruesit kryesorë. Shoqëria aktualisht po vlerëson ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.

Përveç nëse është përshkruar ndryshe, standardet dhe interpretimet e reja nuk priten të ndikojnë ndjeshëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare dhe janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme nga Shoqëria, përveç nëse është shprehur ndryshe.

(a) Investimet e përbashkëta

Marrëveshje të përbashkëta. Sipas SNRF 11, investimet në marrëveshjet e përbashkëta klasifikohen si operacione të përbashkëta ose sipërmarrje të përbashkëta, në varësi të të drejtave dhe detyrimeve kontraktuale të secilit investitor. Shoqëria ka vlerësuar natyrën e marrëveshjes së saj të përbashkët me Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group sh.a. në VIG Services sh.p.k. dhe i vendosi ata të jenë sipërmarrje të përbashkët.

Sipërmarrjet e përbashkëta trajtohen duke përdorur metodën e kapitalit neto. Sipas metodës së kapitalit të kontabilitetit, interesat në sipërmarrjet e përbashkëta fillimisht njihen me kosto dhe përshtaten më pas për të njohur pjesën e Shoqërisë në fitimet ose humbjet e pas blerjes dhe lëvizjet në të ardhura të tjera përmbledhëse. Kur pjesa e humbjeve të shoqërisë në një sipërmarrje të përbashkët është e barabartë ose tejkalon interesat e saj në sipërmarrjet e përbashkëta (që përfshin çdo interes afatgjatë që, në thelb, është pjesë e investimit neto të shoqërisë në sipërmarrjet e përbashkëta), Shoqëria nuk njeh humbje të mëtejshme, përveç nëse ka pasur detyrime ose ka bërë pagesa në emër të sipërmarrjeve të përbashkëta.

Monedha funksionale dhe e prezantimit

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare të cilat janë njohur me kosto historike perkthehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

(b) Klasifikimi i kontratave të sigurimit

Produktet e sigurimit të Shoqërisë klasifikohen ne momentin e krijimit, për arsye kontabël, si kontrata sigurimi. Një kontratë, e cila klasifikohet si kontratë sigurimi mbetet e tillë derisa të gjitha të drejtat dhe detyrimet shuhen ose pushojnë së ekzistuari. Kontrata nën të cilat Shoqëria pranon të marrë një rrezik sigurimi të rëndësishëm nga një palë tjetër (policë-mbajtësi) duke rënë dakort të kompensojë policë-mbajtësin ose përfitues të tjerë për një ngjarje të caktuar të pasigurtë (ngjarja siguruese) e cila ka efekte negative dhe ndikon në policë-mbajtësin apo përfituesit e tjerë, klasifikohet si kontratë sigurimi. Rreziku i sigurimit është i ndryshëm nga rreziku financiar.

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(b) Klasifikimi i kontratave të sigurimit (vazhdim)

Rreziku financiar është rreziku i ndryshimeve të ardhshme të mundshme në një ose më shumë norma interesi specifike, çmimet e letrave me vlerë, çmimet e komoditeteve, kursi i këmbimit, indekset e çmimeve ose të normave, vlerësimi i aftësisë kredituese, indekset e kreditimit ose variabla të tjerë, të siguruar në rastin e variablave jo-financiarë kur variabli nuk është specifik për një palë në kontratë. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë një pjesë të rrezikut financiar.

Kontratat e përgjithshme të sigurimit

Detyrimet e sigurimit janë llogaritur në mënyrë të vecantë për të gjitha produktet e sigurimit dhe janë të përbëra nga primet e angazhimeve të ardhshme (të pafituara), rreziku i angazhimeve të ardhshme (të pambaruara) dhe humbjet e angazhimeve të ardhshme (të papaguara në datën e mbylljes të vitit financiar). Detyrimet e sigurimit (provigjonet) paraqesin vlerësime të pagesave të ardhëshme për dëmet e raportuara dhe të paraportuara. Shoqëria nuk i skonton detyrimet e sigurimit. Çdo ndryshim në vlerësim është reflektuar në rezultatet e operacioneve në periudhën në të cilën vlerësimet janë ndryshuar. Vlerësimi i detyrimeve të sigurimit është një proces kompleks që lidhet me pasiguritë dhe kërkon përdorimin e vlerësimeve dhe gjykimeve të informuara. Shoqëria ka përdorur kërkesat e legjislacionit shqipëtar të sigurimeve për të përcaktuar detyrimet e sigurimit.

Prime të krijuara nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimit

Primet e shkruara bruto përbëjnë shumat e detyruara gjatë vitit financiar në përputhje me sigurimin direkt pavarësisht faktit se këto shuma mund ti perkasin plotësisht ose pjesërisht një periudhe kontabël të mëpasshme. Primet prezantohen bruto nga detyrimet e komisioneve ndaj ndërmjetesve dhe nuk përfshijnë tatimet dhe detyrime doganore të bazuara tek primet. Primet janë fituar që nga data e lidhjes me rrezikun, për periudhën e dëmshpërblimit, në bazë të rrezikut të nënshkruar.

Rezerva për primin e pafituar

Rezerva e primit të pafituar në të gjitha segmentet e biznesit përfshin atë pjesë të primeve të shkruara bruto e cila vlerësohet të fitohet në vitin financiar pasardhës, duke përdorur metodën ditore në bazë proporcionale 1/365, e rregulluar nëse nevojitet në mënyrë që të reflektojë çdo ndryshim të ndodhjes së rrezikut gjatë periudhës së mbuluar nga kontrata. Megjithatë, të gjitha produktet e Shoqërisë kanë rrezik linear dhe asnjë rregullim për ndryshime të rrezikut nuk është bërë.

Primi i pafituar është ajo pjesë e primit e cila lidhet me periudha pas datës së raportimit. Primi i pafituar llogaritet nga primet e nënshkruara të cilat prezantohen bruto nga detyrimet e komisioneve ndaj ndërmjetësve dhe përjashtojnë tatimet dhe detyrimet doganore të bazuara tek primet. Kostot e shtyra të marrjes në sigurim njihen më vete si aktive.

Kostot e shtyra të marrjes ne sigurim

Kostot e shtyra të marrjes në sigurim janë pjesa e kostove të marrjes në sigruim të cilat zbriten gjatë llogaritjes së rezervës së primit të pafituar.

Për të lidhur kostot e blerjes me të ardhurat përkatëse të primit, kostot e blerjes ndahen nga grupime sipas kontratave të sigurimit në përputhje me mënyrën e blerjes, sherbimit dhe matjes së rentabilitetit të kontratave të sigurimit të shoqërisë. Kostot e blerjes të paamortizuara klasifikohen si një aktiv.

Dëmet të krijuara nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimit

Dëmet e ndodhura përbëhen nga shuma e shlyerjes dhe kostot e trajtimit të dëmeve të paguara ose të papaguara të lindura nga ngjarje të ndodhura në vitin financiar, së bashku me rregullime në provizionet e dëmeve të vuteve të mëparshme.

Dëmet e papaguara vlerësohen duke rishikuar dëmet individuale dhe duke provigjonuar dëmet e ndodhura por ende të paraportuara, efekti i ngjarjeve të parashikuara të brendëshme dhe të jashtëme, të tilla si ndryshimet e procedurave në trajtimin e dëmeve, inflacioni, tendencat juridike, ndryshimet legjislative dhe eksperiencat e mëparëshme. Provigjoni për dëmet e papaguara nuk skontohet.

Rregullimet për provigjonin e dëmeve të viteve të mëparëshme reflektohen në pasqyrat financiare të periudhës në të cilën bëhen rregullimet dhe paraqiten më vete nëse janë materiale. Provigjonet për pretendimet e ndodhura por të pa raportuara vlerësohen bazuar në metodën e trekëndëshave për produktet

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(b) Klasifikimi i kontratave të sigurimit (vazhdim)

e përgjegjësisë së palës së tretë motorike ("MTPL") ndërsa për linjat e tjera të biznesit përdoret një metodologji e thjeshtuar e bazuar në raportin e Primeve të përfituara, duke qënë se ka mungesë në të dhënat historike në lidhje më humbjet. Nderkohë që Bordi i Drejtorëve konsideron se detyrimet e sigurimit për dëmet dhe marrjet nga risigurimi janë të drejta, detyrimi përfundimtar mund të ndryshojë si rrjedhojë e informacioneve dhe ngjarjeve të mëvonshme dhe mund të rezultojë në një rregullim të shumës së dhënë. Rregullimet për detyrimet e sigurimit reflektohen në pasqyrat financiare në periudhën në të cilën bëhet rregullimi.

Angazhimet për dëmet në proces gjyqësor

Një numër i konsiderueshëm i kërkesave për tu paguar janë në proces gjyqësor dhe për të cilën Shoqëria ka njohur detyrimet përkatëse në bazë të vlerësimit të menaxhimit (shënimi 37).

(i) Risigurimi

Shoqëria cedon primet e siguruara dhe rrezikun në rrjedhën normale të biznesit me potencialin e humbjes neto nëpërmjet diversifikimit të rrezikut që krijohet nga linjat e biznesit të MTPL, Pasurisë, Kartoni Jeshil, anije dhe avion, civile dhe përgjegjësi dhe linja të tjera biznesi. Risigurime të tilla përfshijnë marrëveshjet për tejkalimin e humbjeve, marrëveshjet për ndarjen e kuotave dhe marrëveshjet fakultative. Vetëm kontratat që përfshijnë transferimin e një pjese të konsiderueshme të rrezikut të sigurimit dhe atij kohor regjistrohen si aktive të sigurimit. Marrëveshjet e risigurimit nuk e çlirojnë shoqërinë nga detyrimet direkte ndaj policë-mbajtësit. Detyrimet e risigurimit përfshijnë llogari të pagueshme për kontrata të jashtëme risigurimi dhe njihen si shpenzime kur u mbaron afati.

Primet e risiguruara për risigurimin e ceduar njihen si shpenzim në mënyrë që të jenë konsistente me njohjen e primeve të lidhura me kontratat e sigurimit. Për sigurimin e përgjithshëm të biznesit, primet e risigurimit shpenzohen në periudhën në të cilën mbulimi i risigurimit jepet në bazë të modeleve të rrezikut të risiguruar. Pjesa e pashpenzuar e primit të risigurimit të ceduar përfshihet në aktivet e risiguruara. Shuma e njohur si aktiv i risiguruar matet në mënyrë që të jëtë konsistente me matjet e provigjonit të mbajtur në përputhje me kontratat e sigurimit. Llogaritë e arkëtueshme nga risigurimi përfshijnë komisionet e risigurimit nga primet e ceduara risiguruesit dhe të arkëtueshmet nga shoqëria risiguruese në përputhje me dëmin e paguar.

Këto janë klasifikuar si llogari të arkëtueshme dhe paraqiten të vecanta, nëse ka. Aktivet e risiguruara vlerësohen për zhvlerësim në datën e raportimit. Një aktiv konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive, si rezultat i një ngjarje të ndodhur pas njohjes fillestare, që njësia raportuese mund të mos marrë të gjitha shumat që i detyrohen dhe ngjarja ka një impakt besueshmërisht të matshëm në shumat që njësia raportuese do të marrë.

ii) Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve

Në çdo datë raportimi Shoqëria bën një test të mjaftueshmërisë të rezervave të dëmeve. Testet e para që realizohen janë Analiza e Raportit të Dëmeve dhe Analizën e Zhvillimit të provizioneve të dëmeve. Analiza e raportit të dëmeve realizohet çdo vit në mënyrë individuale për linjat kryesore të biznesit. Llogaritjet realizohen më vete për dëmet si dhe për dëmet që përfshijnë kostot e blerjeve si dhe kosto të tjera të jashtëme për trajtimin e dëmeve. Në realizimin e kësaj analize Shoqëria merr në konsideratë vleresimet aktuale të flukseve monetare dalëse. Shoqëria nuk i skonton këto flukse monetare pasi pjesa më e madhe e dëmeve priten të zgjidhen brënda një viti.

Për më tepër, Shoqëria kryen çdo vit analizën e zhvillimit të provizioneve të dëmeve për të përcaktuar metodologjinë e rezervës. Kjo analizë kryhet në mënyrë të vecantë por dhe të kombinuar për RBNS (të raportuara por ende të pambyllura) dhe IBNR (të ndodhura por të paraportuara). Në rastet kur analiza paraqet parregullsi të theksuara, rregullime të caktuara i bëhen metodologjisë së rezervës.

Nëse një mungesë indentifikohet ajo i alokohet fitimit ose humbjes duke krijuar një provigjon për rrezikun e paskaduar nga humbjet që lindin nga testi i mjaftueshmerisë së detyrimeve.

iii) Portofoli i rezervës së primeve

Kur një risigurues i ri merr pjesë në një marrëveshje me bazë vitin kontabël ose kur përfshirja në një periudhë, për një risigurues ekzistues rritet, ky funksion llogarit primin e pafituar marrë nga risiguruesi për pjesëmarrje në rreziqet për të cilat primi është mbledhur por nuk është fituar ende. Hyrja e portofolit të primit në fillim të periudhës së risigurimit është pjesa e përqindjes së risigurimit të primeve të pafituara në fillim të periudhës.

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(c) Instrumentet financiare

Instrumentet financiare të shoqërisë maten me koston e amortizuar në varësi të kategorisë së matjes së tyre.

i) Njohja

Instrumentet financiare të shoqërisë (aktivet dhe detyrimet) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare dëshmohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Një fitim ose humbje në njohjen fillestare regjistrohet vetëm nëse ka një diferencë midis vlerës së drejtë dhe çmimit të transaksionit që mund të evidentohen nga transaksionet e tjera të tregut të tanishëm të vrojtueshëm në të njëjtin instrument ose me një teknikë vlerësimi, inputet e të cilave përfshijnë vetëm të dhënat nga tregjet e vëzhgueshme.

ii) Klasifikimi

Aktivet financiare të shoqërisë janë klasifikuar si hua dhe të arkëtueshme (depozita me afat me bankat dhe të arkëtueshmet e sigurimeve). Letrat me vlerë të qeverisë Shqiptare nuk janeë klasfifikuar si të mbajtura deri ne maturim pasi nuk ka nje treg aktiv për këto instrumenta dhe prandaj ato përmbushin përshkrimin e huave dhe të arkëtueshmeve. Detyrimet financiare janë klasifikuar si detyrime të tjera financiare (përfshirë detyrimet e sigurimit / tregtisë dhe detyrimet e tjera) dhe janë përllogaritur kur pala tjetër kryen detyrimet e saj sipas kontratës dhe mbahen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. ***Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme*** janë aktive financiare jo-derivative të pa kuotuara me pagesa fikse ose të përcaktueshme të tjera përveç atyre që shoqëria synon të shesë në të ardhmen e afërt. Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme përfshijnë depozitat me afat me bankat dhe sigurimet dhe të arkëtueshmet e tjera dhe letrat me vlerë të qeverisë mbahen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, neto e provizionit për humbjet e shkaktuara nga zhvlerësimi.

iii) Çregjistrimi

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar nëse (a) humbet të drejtat kontraktuale mbi flukset e ardhshme të parasë ose (b) transferon të drejtat për të marrë flukset kontraktuale të parasë nga aktivet financiare në transaksione ose ka hyre në transaksione përmes ndërkohë që (i) është transferuar i gjithë rreziku dhe përfitimet nga aktivet financiare ose (ii) as janë transferuar as janë ruajtur në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, por pa mbajtur kontrollin. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësinë e saj për një palë të tretë të palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shuhen, anullohen ose maturohen.

iv) Matja e kostos së amortizuar

Kosto e amortizuar e një aktivi apo detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar është matur në njohjen fillestare, duke zbritur këstet e paguara, plus ose minus amortizimin kumulativ. Interesi i përllogaritur përfshin amortizimin e kostove të transaksionit të shtyra në njohjen fillestare dhe të çdo primi ose zbritje deri në maturim duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat e përllogaritura të interesit dhe shpenzimet e përllogaritura të interesit, duke përfshirë edhe kuponin e përllogaritura dhe zbritjen ose shpërblimin e përllogaritur (përfshirë tarifat e shtyra në fillim, nëse ka), nuk paraqiten vecmas dhe përfshihen në vlerat bartëse të zërave në pasqyrën e pozicionit financiar.

v) Netimi

Aktivet dhe detyrimet financiare mund të netohen dhe tepricat neto të paraqiten në bilanc vetëm kur Shoqëria ka të drejta ligjore për të netuar shumat dhe ka për qëllim të arkëtojë ose të mbyllë aktivin apo detyrimin neto në të njëjtën kohë. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten të netuara vetëm kur lejohet nga standartet e kontabilitetit, ose për fitime dhe humbje që lindin nga transaksione me natyrë të njëjtë përgjatë aktivitetit të Shoqërisë.

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(c) Instrumentet financiare (vazhdim)

vi) Zhvlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura me koston e amortizuar

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje kur ndodhin si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve ("ngjarja") që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit financiar dhe që kanë ndikim në shumën ose kohën e flukseve monetare të ardhshme të vlerësuara të aktivit financiar ose grupit të aktiveve financiare që mund të vlerësohen me besueshmëri. Nëse shoqëria konstaton se nuk ka dëshmi objektive se zhvlerësimi ka ndodhur për një aktiv financiar të vlerësuar individualisht, qoftë i rëndësishëm apo jo, ai përfshin aktivin në një grup aktivesh financiare me karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë dhe vlerëson kolektivisht ato për zhvlerësim duke përdorur matricën që merr në konsideratë historikun dhe të ardhmen e parashikuar. Faktorët kryesorë që shoqëria konsideron në përcaktimin nëse një aktiv financiar është zhvlerësuar janë statusi i saj i vonuar, detyrimet që mund të kompensohen për të njëjtin klient dhe realizueshmëria e kolateralit të lidhur, nëse ka.

Kriteret e tjera kryesore të mëposhtme përdoren gjithashtu për të përcaktuar nëse ka dëshmi objektive që ka ndodhur një humbje nga zhvlerësimi:

- çdo pjesë ose këst është vonuar dhe pagesa e vonuar nuk mund t'i atribuohet një vonese të shkaktuar nga sistemet e shlyerjes;
- pala përjeton një vështirësi të konsiderueshme financiare siç dëshmohet nga informacionet e saj financiare;
- pala tjetër është në faliment ose riorganizim financiar;
- ka ndryshim negativ në statusin e pagesave të palës tjetër, si rezultat i ndryshimeve në kushtet ekonomike kombëtare ose lokale që ndikojnë palën; ose
- vlera e kolateralit, nëse ka, zvogëlohet ndjeshëm si rezultat i përkeqësimit të kushteve të tregut.

(d) Mjete monetare dhe ekuivalentet me to dhe depozitat me afat

Mjetët monetare dhe ekuivalentë me to përfshijnë balancat e gjendjes në arkë, mjetet monetare të depozituara në banka të nivelit të dytë dhe investime afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe me maturitet deri në tre muaj ose më pak që nga momenti i blerjes. Mjete monetare dhe ekuivalente me to mbahen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Depozitat me afat me maturitet fillestar më shumë se tre muaj janë kalsifikuar si depozita me afat me bankat si kategori e huave dhe të arkëtueshme nga asetet financiare.

(e) Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerë të drejtë dhe më tej maten me kosto të amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi dhe përfshijnë paratë e mbajtura nga agjentët. Të arkëtueshmet nga sigurimi vlerësohen për zhvlerësim në çdo datë raportimi.

(f) Parapagimet

Parapagimet mbahen me kosto minus provizionin për zhvlerësim dhe përfshihen në aktivet e tjera. Parapagimet për blerjen e aktiveve transferohen në vlerën kontabël të aktivit sapo shoqëria ka marrë kontrollin e aktivit dhe është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme që lidhen me aktivin do të rrjedhin në shoqëri. Pagesat paraprake të tjera shlyhen në fitim ose humbje kur merren mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimet. Nëse ka një indikacion se asetet, mallrat ose shërbimet që lidhen me një parapagim nuk do të pranohen, vlera bartëse e parapagimit shlyhet në përputhje me rrethanat dhe një humbje përkatëse e zhvlerësimit njihet në fitim ose humbje për vitin.

(g) Garancia e kartonit jeshil

Një nga linjat e biznesit të shoqërisë është sigurimi i kartonit jeshil. Aktualisht, Shqipëria është nën monitorimin e Byrosë Ndërkombëtare të Sigurimeve në lidhje me aftësitë e shoqërive të tregut të sigurimeve për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga sigurimi i kartonit jeshil.

Për këtë qëllim, Byroja Ndërkombëtare, i ka kërkuar Byrosë Shqiptare të Sigurimit të depozitojë një garanci në favor të saj e cila mund të shfrytëzohet në qoftë se një nga shoqëritë e sigurimit Shqiptare dështon në përmbushjen e detyrimeve të sigurimit nga kartoni jeshil.

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Garancia e Kartonit Jeshil (vazhdim)

Shoqëria kontribuon në bazë të pjesës së saj të sigurimit në kartonin jeshil tek depozita e Byrosë Shqiptare të Sigurimeve. Kontributi njihet nga Shoqëria si një garanci në aktive të tjera, të cilat do të rimbursohen tek shoqëria sapo Zyra Ndërkombëtare të heqë kërkesën për depozitimin e garancisë.

(h) Taksat

Tatimet mbi të ardhurat janë parashikuar në pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin e miratuar ose të nxjerrë në mënyrë substanciale deri në fund të periudhës raportuese. Ngarkesa e tatimit mbi të ardhurat përbën tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë dhe njihet në fitim ose humbje për vitin, përveç nëse ajo njihet në të ardhura të tjera përmbledhëse ose drejtpërdrejt në kapital sepse lidhet me transaksionet që njihen gjithashtu, në të njëjtën ose në një tjetër periudhë, në të ardhura të tjera përmbledhëse ose direkt në kapital. Tatimi aktual është shuma që pritet të paguhet ose të rimbursohet nga autoritetet tatimore në lidhje me fitimet ose humbjet e tatueshme për periudhat aktuale dhe të mëparshme. Fitimet ose humbjet e tatueshme bazohen në vlerësimet nëse pasqyrat financiare janë të autorizuara para se të dorëzojnë deklaratat përkatëse tatimore. Tatimet përveç të ardhurave regjistrohen tek shpenzimet operative.

Tatimi i shtyrë mbi të ardhurat është llogaritur duke përdorur metodën e detyrimeve në bilanc për humbjen tatimore të mbartur dhe diferencat e përkohshme që dalin ndërmjet bazave tatimore të aktiveve dhe detyrimeve dhe vlerave të tyre bartëse për qëllime të raportimit financiar. Në përputhje me përjashtimin fillestar të njohjes, tatimet e shtyra nuk regjistrohen për diferencat e përkohshme në njohjen fillestare të një aktivi ose një pasivi në një transaksion tjetër nga një kombinim biznesi nëse transaksioni, kur regjistrohet fillimisht, nuk ndikon as në kontabilitet, as fitim të tatueshëm. Tatimi i shtyrë mbi të ardhurat është matur me normat tatimore të miratuara ose të vendosura substancialisht në fund të periudhës raportuese, të cilat pritet të zbatohen në periudhën kur do të ndryshojnë diferencat e përkohshme ose do të përdoret humbja tatimore përpara. Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme dhe humbjet tatimore që barten në të ardhurat regjistrohen vetëm në masën që është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm të jetë në dispozicion kundrejt të cilit mund të përdoren zbritjet.

Pozicionet e pasigurta tatimore Pozicionet e pasigurta tatimore të Grupit rishqyrtohen nga menaxhimi në fund të çdo periudhe raportuese. Detyrimet regjistrohen për pozicionet e tatimit mbi të ardhurat të cilat përcaktohen nga menaxhimi, pasi ka më shumë gjasa që të rezultojë në vendosjen e taksave shtesë nëse pozicionet do të kundërshtoheshin nga autoritetet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore që janë miratuar ose në thelb të miratuara deri në fund të periudhës raportuese, dhe çdo vendim i njohur gjykate ose vendim tjetër për çështje të tilla. Detyrimet për gjobat, interesat dhe taksat e tjera veçmas të ardhurave njihen në bazë të vlerësimin më të mirë të drejtimit për shpenzimet e kërkuara për të shlyer detyrimet në fund të periudhës raportuese.

(i) Aktive të trupëzuara

Pronat dhe pajisjet maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka. Kostoja përfshin shpenzimet qe lidhen drejtpërdrejt me koston e blerjes së aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte (nëse ka patur), çdo kosto tjetër drejtpërdrejt e atribuueshme që sjell aktivin në gjendjen e tij të parashikuar të punës, si dhe kostot e çmontimit dhe zhvendosjes së aktivit dhe rikthimit të vendndodhjes së tij në gjendjen e mëparshme. Kur pjesët e një aktivi kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato konsiderohen si elementë të veçantë (komponentë kryesorë) të pajisjes

Humbjet dhe fitimet nga nxjerrja jashtë përdorimit të një elementi të paisjeve përcaktohen përmes krahasimit të të ardhurave të gjeneruara nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën e mbetur të pajisjes, dhe njihen neto brënda të ardhurave të tjera në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(i) Aktive të trupëzuara (vazhdim)

Kosto e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbetur të elementit nëse pritet që prej këtij zëvendësimi të rrjedhin përfitime të ardhshme ekonomike për Shoqërinë dhe nëse kjo kosto mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të riparimit të përhershëm të pajisjeve njihen në pasqyrën e të ardhura shpenzimeve kur ato ndodhin.

Toka, parapagimet dhe aktivet në ndërtim nuk zhvlerësohen. Zhvlerësimi i ndërtesave dhe kategoria e përmirësimit në infrastrukturë realizohet përmes metodës lineare mbi jetëgjatësinë e vlerësuar të aktiveve, ndërsa zhvlerësimi i aktiveve të tjera përllogaritet sipas metodës së vlerës së mbetur.

Supozimet për vlerësimin e jetëgjatësis të aktiveve të trupëzuara për periudhën aktuale dhe krahasuese është si vijon:

Ndërtesa dhe përmirësime të qeramarrjeve	20 vjet
Mjete motorrike	5 vjet
Kompjutera, Pajisje zyre dhe orendi	5 vjet
Kompjutera dhe programe kompjuterike	4 vjet

Vlera e mbetur, nëse jo e parëndësishme, rivlerësohet në mënyrë të përvitshme. Përmirësimet e qeramarrjeve kapitalizohen dhe zhvlerësohen për më të voglën midis jetës së dobishme dhe kohëzgjatjes së qerasë.

Metodat e zhvlerësimit dhe jeta e dobishme rishikohen dhe rregullohen nëse është e nevojshme, në çdo datë raportimi.

(j) Aktive të patrupëzuara

Aktivet e patrupëzuara kanë jetë të dobishme të përcaktuar dhe kryesisht përfshijnë softuere kompjuterike, patenta, marka tregtare dhe liçenca. Liçencat e softuerëve kompjuterikë, patentat dhe markat tregtare kapitalizohen në bazë të kostove për t'i blerë dhe për t'i sjellë në përdorim.

Shpenzimet e zhvillimit që lidhen drejtpërdrejt me programet softuere të identifikueshme dhe unike të kontrolluara nga shoqëria regjistrohen si aktive të patrupëzuara nëse tejkalimi I kostove nga shtesat e flukseve të përfitimeve ekonomike është i mundshëm. Shpenzimet e kapitalizuara përfshijnë kostot e stafit të zhvillimit të softuerit dhe një pjesë të përshtatshme të shpenzimeve të përgjithshme. Të gjitha shpenzimet e tjera që lidhen me softuerin kompjuterik, p.sh. mirëmbajtjen e tij, regjistrohen si shpenzime kur ndodhin.

Aktivet e patrupëzuara amortizohen duke përdorur metodën lineare gjatë jetës së tyre të dobishme prej 4 vjetësh.

(k) Aktivet të mbajtura për investime

Prona për investim është pronë e mbajtur nga shoqëria për të fituar të ardhura nga qiraja ose për vlerësimin e kapitalit, ose të dyja dhe të cilat nuk janë të zëna nga shoqëria. Prona e investimit përfshin aktivet në ndërtim e sipër për përdorim në të ardhmen si pronë e investimit, nëse është rasti.

Prona për investim mbahet me kosto, minus zhvlerësimin e akumuluar (e njëjta metoda dhe jetë të dobishme si pronat dhe pajisjet) dhe provigjoni për zhvlerësim, kur kërkohet. Nëse ka ndonjë tregues se prona për investim mund të zhvlerësohen, shoqëria vlerëson shumën e rikuperueshme si vlera më e lartë midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit. Vlera kontabël neto e një aktivi afatgjatë material të investuar shënohet deri në shumën e rikuperueshme në fitim ose humbjen për vitin. Një humbje nga zhvlerësimi e njohur në vitet paraprake shfuqizohet nëse ka pasur një ndryshim pasues në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar shumën e rikuperueshme të aktivit. Shpenzimet e mëvonshme kapitalizohen vetëm kur është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me sendin do të rrjedhin tek shoqëria, dhe kostoja mund të matet në mënyrë të besueshme. Të gjitha riparimet e tjera dhe shpenzimet e mirëmbajtjes shpenzohet kur ndodhin. Nëse një pasuri e investimit përdoret nga pronari, ajo riklasifikohet në pasuri, makineri dhe pajisje.

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(l) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, me përjashtim të aktiveve tatimore të shtyra, shqyrtohet në çdo datë bilanci për të përcaktuar nëse ekziston ndonjë tregues për rënie në vlerë. Në qoftë se ekziston ndonjë tregues i tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperushme e aktivit, e cila përcaktohet si vlera më e lartë e një aktivi mes vlerës së drejtë minus kostot për shitje dhe vlerës së saj në përdorim. Humbja nga rënia në vlerë njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi e njohur për një aktiv në vitet e mëparshme kthehet kur është e përshtatshme nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e aktivit në përdorim ose vlerën e drejtë minus kostot për shitje.

(m) Kapitali aksionar

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Kostot që i atribuohen drejtpërdrejt emetimit të aksioneve të reja janë paraqitur në kapital si një zbritje nga të ardhurat, neto nga tatimi. Çdo tejkalim i vlerës së drejtë të shumës së marrë mbi vlerën nominale të aksioneve të emetuara regjistrohet si pronë e aksioneve në kapitalin neto.
Dividendët regjistrohen si pasiv dhe zbriten nga kapitali në periudhën në të cilën ato janë deklaruar dhe miratuar. Çdo divident i deklaruar pas periudhës raportuese dhe para se të mbyllen pasqyrat financiare, janë shprehur në shënimet e ngjarjeve pas periudhës raportuese.

(n) Rezerva e riskut të sigurimit

Rezerva e riskut të sigurimit krijohet bazuar në Nenin 93 të Ligjit për Sigurimet dhe është e barabartë me një të tretën e fitimeve të periudhës së mëparshme nëse fitimet nuk përdoren për të mbuluar humbje të akumuluara të trashëguara prej viteve të mëparshme. Kjo rezervë nuk rritet më tepër se 30% e primeve mesatare të arkëtuara në dy vitet e fundit. Kjo rezervë krijohet për të garantuar aftësinë paguese dhe fondin e garancisë dhe nuk mund të përdoret nga shoqëria për ndonjë qëllim tjetër. Shoqëria nuk është e detyruar të krijojë një rezervë ligjore si një shoqëri sigurimi e cila i nënshtrohet rezervës së rrezikut të sigurimit të përcaktuar me Aktin e Sigurimit.

(o) Njohja e të ardhurave

Primet

Politikat kontabël në lidhje me të ardhurat nga kontratat e sigurimit janë sqaruar në shënimin 5(b).

Të ardhurat nga interesat

Të ardhurat nga interesi njihen në fitimin ose humbjen si të fituara, duke marrë parasysh interesin efektiv të aktivit. Të ardhurat nga dividenti njihen në fitim ose humbje në datën e deklarimit të dividendit.

Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet

Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet përfshijnë komisionin e risigurimit, të njohur në marrëveshjen me risiguruesit. Komisionet e risigurimit vazhdojnë të njihen plotësisht në marrëveshjen me risiguruesin.

Të ardhurat nga qiraja

E ardhura nga qeraja njihet në mënyrë lineare përgjatë kohëzgjatjes së qerasë.

(p) Shpenzimet e blerjes së policave

Shpenzimet e blerjes përcaktohen si kosto që rrjedhin nga blerja e kontratave të reja të sigurimit, duke përfshirë kostot direkte, siç janë komisionet e blerjes dhe koston e hartimit të dokumentit të sigurimit.

Shpenzimet e blerjes së drejtpërdrejtë shtyhen gjatë afatit të policave në fuqi me një metodë në përputhje me llogaritjen e provizioneve të primeve të pafituara dhe paraqiten bruto nga detyrimet e lidhura të sigurimit si një aktiv. Shpenzimet e shtyra të blerjes amortizohen sistematikisht gjatë jetës së kontratës dhe testohen për zhvlerësim në çdo datë raportimi. Çdo shumë që nuk kthehet regjistrohet si shpenzim.

Kostot e trajtimit të dëmeve

Kostot e trajtimit të dëmeve konsistojnë në shpenzimet e jashtme të trajtimit të dëmeve dhe nuk përfshijnë shpenzime të brendshme të mbulimit të dëmeve të cilat konsiderohen të jenë të parëndësishme krahasuar me kostot e jashtme. Shoqëria krijon provigjone për kostot e trajtimit të dëmeve.

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(q) Shpenzimet

Shpenzimet operative. Shpenzimet operative njihen kur ndodhin.

Përfitimet e punonjësve. Pagat, shpërblimet, kontributet në fondet shtetërore ose private, fondet e sigurimeve shoqërore, pushimet vjetore dhe pushimet mjekësore, shpërblimet dhe përfitimet jo monetare grumbullohen në vitin në të cilin shërbimet janë kryer.

Shoqëria nuk ka asnjë detyrim ligjor për të bërë pagesa të pensioneve ose përfitimeve të ngjashme përtej pagesave në skemën e kontributeve të përcaktuara statutore dhe private.

Pagesat e qerasë operative. Pagesat e bëra për qeratë operative njihen në pasqyrën humbje fitimeve me metodën lineare përgjatë kohëzgjatjes së qerasë.

(r) Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat e fondeve të investuara në depozita bankare dhe fitimet nga kurset e këmbimit. Të ardhurat nga interesat njihen në bazë të të drejtave të konstatuara, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesave të huamarrjeve dhe humbjet nga kurset e këmbimit. Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit raportohen në baza neto.

6. Vlerësimet dhe gjykimet në zbatimin e politikave kontabël

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerat kontabël të mbartura të aktiveve dhe pasiveve në vitin e ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën e menaxhimit dhe në faktorë të tjerë, duke përfshirë pritjet e ngjarjeve të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme. Menaxhimi gjithashtu bën gjykime të caktuara, përveç atyre që përfshijnë vlerësime, në procesin e zbatimit të politikave kontabël. Gjykimet që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerësimet që mund të shkaktojnë një rregullim domethënës në vlerën kontabël të mbartur të aktiveve dhe pasiveve brënda vitit të ardhshëm financiar përfshijnë:

Pretendimet dhe përfitimet e policëmbajtësit

Vlerësimi i detyrimit përfundimtar që rrjedh nga pretendimet e bëra sipas kontratave të sigurimit është vlerësimi kryesor kontabël i shoqërisë. Vendimet e shoqërisë për humbjet e raportuara dhe të papërmendura dhe vendosja e provigjoneve rezultuese dhe risigurimi i lidhur me të, rikuperohen çdo vit dhe përditësohen dhe rregullimet që rrjedhin nga ky rishikim pasqyrohen në fitim ose humbje.

Procesi bazohet në supozimin se përvoja e kaluar, e përshtatur për efektin e zhvillimeve aktuale dhe tendencat e mundshme, është një bazë e përshtatshme për parashikimin e ngjarjeve të ardhshme. Menaxhimi i riskut të sigurimit diskutohet në detaje në shënimin 8, ndërsa dispozitat e kontratës së sigurimit analizohen në shënimin 22 dhe 23.

Të arkëtueshmet nga sigurimet dhe humbjet nga zhvlerësimi

Sigurimet dhe llogaritë e tjera të arkëtueshme fillimisht njihen me vlerën e drejtë. Më pas të arkëtueshmet maten me koston e amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi. Vlerësimi i kompensimit për humbjet nga zhvlerësimi është gjithashtu një vlerësim i kryer nga menaxhimi. Të arkëtueshmet e sigurimeve vlerësohen për zhvlerësim në çdo datë raportimi. Të arkëtueshmet e sigurimeve me më shumë se një vit zhvlerësohen plotësisht nëse nuk ka probabilitet të lartë që ato të mblidhen. Një probabilitet i tillë ekziston kur shoqëria ka marrëdhënie afatgjatë me klientë të rëndësishëm ose kur shoqëria blen mallra dhe / ose shërbime nga i siguruari dhe llogaritë e arkëtueshme shlyhen në baza neto. Të arkëtueshmet e sigurimeve me më pak se një vit janë vlerësohen individualisht në rast se ka tregues se ato të nuk do të mblidhen dot.

Të arkëtueshmet e sigurimeve me më pak se një vit vlerësohen gjithashtu në baza kolektive të grupuara në bazë të karakteristikave të rrezikut të kredisë, zakonisht me datën e raportimit. Përqindjet e zhvlerësimeve të zbatuara për secilën kategori të llogarive të arkëtueshme të sigurimeve me më pak se një vit, përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të menaxhimit për humbjet e pritshme në të ardhmen dhe bazohen në historinë e rikuperueshmërisë dhe përvojën e tregut.

7. Administrimi i rrezikut financiar

Menaxhimi i rrezikut brenda shoqërisë monitoron dhe menaxhon rrezikun financiar, rrezikun operacional dhe rrezikun ligjor. Rreziku financiar përfshin rrezikun e tregut (rreziku i monedhës, rreziku i normave të interesit), rrezikun e kredisë dhe rrezikun e likuiditetit.
Objektivat kryesore të funksionit të administrimit të rrezikut financiar janë vendosja e kufijve të rrezikut dhe më pas sigurimi që ekspozimi ndaj rreziqeve të mbetet brënda këtyre kufijve. Funksionet e menaxhimit të rrezikut operacional dhe ligjor kanë për qëllim të sigurojnë funksionimin e duhur të politikave dhe procedurave të brendshme, në mënyrë që të minimizohen rreziqet operacionale dhe ligjore. Shoqëria nuk përdor instrumenta financiarë derivativë për t'u mbrojtur nga ekspozimi ndaj këtyre rreziqeve.

Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë i referohet rrezikut që pala tjetër do të dështojë në obligimet e saj kontraktuale duke rezultuar në humbje financiare për Shoqërinë. Përgjatë kursit normal të biznesit, teksa arkëtohen primet, këto fonde investohen për të shlyer obligimet e ardhshme të policave. Shoqëria ekspozohet ndaj rrezikut të kredisë përmes titujve të borxhit të mbajtur deri në maturim, depozitave me afat, të arkëtueshmeve të sigurimit dhe kundërpartitë e risigurimit.

Ekspozimi maksimal i shoqërise ndaj rrezikut të kredisë sipas pozicionit financiar është si më poshtë:

	Shënim	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Aktive të risigurimit	13	684,775	723,373
Letra me vlerë me kosto të amortizuar	14	864,673	706,284
Depozita me afat me bankat	15	733,958	777,638
Të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimeve dhe të tjera	18	85,759	112,978
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to	19	54,627	85,935
Ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë		**2,423,792**	**2,406,208**

Shoqëria nuk ka identifikuar asnjë indikacion objektiv për zhvlerësim e aktiveve të tjera financiare në datën e raportimit, prandaj menaxhimi i konsideron aktivet e tjera financiare si ekuivalentët e mjeteve monetare dhe depozitat me afat as të vonuara as të zhvlerësuara.

Shoqëria ka vendosur procedura të brendshme dhe udhëzime sipas të cilave partnerët e risigurimit duhet të kenë vlerësime BBB- ose më të larta sipas S&P dhe të plotësojnë kërkesat e VIG përsa i përket Rregullave të Sigurisë për Risigurimet. Shoqëria ka miratuar politika investimesh për të monitoruar rregullisht ekspozimin e riskut të kredisë nëpërmjetë monitorimit të ekspozimit të aktiveve te mbajtura për investim dhe depozitat në banka të palëve të treta. Risku menaxhohet paraprakisht, nga analiza të repta, rishikime nga bordi dhe mbledhje për të rishikuar zhvillimet e kredive.

Ndikimi i netimit të mundshëm të aktiveve dhe detyrimeve për të zvogëluar ekspozimin e mundshëm të kredisë nuk është i rëndësishëm. Risku i kredisë nuk zbutet nga kolaterali. Shoqëria strukturon nivelet e riskut të kredisë që ajo ndërmerr duke vlerësuar marrëdhëniet dhe duke vendosur kufizime në sasinë e riskut të pranuar në lidhje me palët ose grupet e palëve të tjera. Kufijtë në nivelin e riskut të kredisë miratohen rregullisht nga menaxhimi. Këto risqe monitorohen periodikisht dhe i nënshtrohen një rishikimi vjetor ose dhe më të shpeshtë.

Menaxhimi i shoqërisë shqyrton analizën e vjetersisë të arkëtimeve të sigurimit të papaguara dhe ndjek balancat e kaluara. Prandaj, menaxhimi e konsideron të përshtatshme të japër informacionet e vjetërsisë dhe tinformacionetë tjera rreth riskut të kredisë siç shpjegohet dhe në Shënimin 18.

Risku i kredisë për instrumentat financiarë jashtë bilancit përkufizohet si mundësi e mbajtjes së një humbjeje si rezultat e një pale tjetër në një instrument financiar që nuk zbaton kushtet e kontratës. Ekspozimet e tilla nuk janë materiale.

7. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Rreziku i tregut

Rreziku i tregut përfshin tre tipe rreziku:

- Rreziku nga ndryshimet në kurset e këmbimit – rreziku që vlera e një instrumenti financiar të luhatet për shkak të ndryshimeve në kursin e këmbimit valutor.
- Rreziku i normës së interesit të vlerës së drejtë - rreziku që vlera dhe flukset monetare të një instrumenti financiar do të luhatet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut.
- Rreziku i çmimit rrezikuqë vlera e një instrumenti financiar do të luhatet si rezultat i ndryshimeve në çmimet e tregut, qofshin këto janë ato ndryshime të shkaktuara nga faktorë specifikë për instrumentin individual ose emetuesin e tij ose faktorët që ndikojnë në të gjitha instrumentet e tregtuara në treg.

Rreziku i tregut mund të sjellë jo vetëm potencial për humbje, por edhe mundësinë për fitim.

Menaxhimi përcakton kufijtë mbi vlerën e rrezikut që mund të pranohet, i cili monitorohet në baza ditore. Megjithatë, përdorimi i kësaj qasjeje nuk parandalon humbjet jashtë këtyre kufijve në rast të lëvizjeve më të rëndësishme të tregut.

Ndjeshmëria ndaj rrezikut të tregut përfshirë më poshtë bazohet në një ndryshim në një faktor ndërkohë që mbahen të gjithë faktorët e tjerë konstant. Në praktikë kjo nuk ka gjasa të ndodhë dhe ndryshimet në disa nga faktorët mund të jenë të lidhura - për shembull, ndryshimet në normën e interesit dhe ndryshimet në normat e monedhës së huaj.

Rreziku i monedhës

Shoqëria ndërmerr transaksione si në monedhën lokale ashtu edhe në monedha të huaja; ndaj edhe lind rreziku prej luhatjes së kurseve të këmbimit. Për këtë arsye, luhatjet në kurset e këmbimit të monedhave të huaja mund të ndikojnë nivelin e kapitalit të aksionerëve si rezultat kjo i përkthimit të tij në monedhën lokale. Rreziku i monedhës në portofolin e investimeve menaxhohet përmes përdorimit të parimit të përputhshmërisë së aktiveve me detyrimet. Normat zyrtare sipas Bankës Qendrore (Lekë për njësi të monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2017		**31 dhjetor 2017**	
	Mesatarja për vitin 2018	Në mbyllje	Mesatarja për vitin 2017	Në mbyllje
Dollari Amerikan (USD)	108.00	107.82	118.33	111.11
Euro (EUR)	127.57	123.42	134.13	132.95

Shoqëria nënshkruan polica në Lekë, Euro ose USD. Ajo hyn në marrëveshje të risigurimit kryesisht në Euro dhe blen mallra dhe shërbime në Euro dhe Lekë ose në USD. Sigurimet, dëmet dhe rezervat janë kryesisht në monedhën e polices së nënshkruar. Prandaj dhe shoqëria është e ekspozuar nga rreziku i monedhës.

Politikat dhe proceset e shoqërisë përqëndrohen në lehtësimin e rrezikut të monedhës, përmes balancimit të shumës së parave të gatshme të përdorura në çdo monedhë, kryesisht duke investuar në depozitat me afat për të përputhur detyrimet që rezultojnë në monedhat përkatëse.

7. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Aktivet dhe detyrimet e shoqërisë të shprehura në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

(Në '000 Lekë)	Në Lekë	Në EUR	Në USD	Totali
Aktivet				
Aktivet e risigurimit	549,038	135,734	3	684,775
Letra me vlerë me kosto të amortizuar	683,686	180,987	-	864,673
Depozita me afat me bankat	607,759	126,199	-	733,958
Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera	7,511	76,793	1,455	85,759
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to	23,009	29,550	2,068	54,627
Totali i aktiveve financiare	**1,871,003**	**549,263**	**3,526**	**2,423,792**
Detyrimet				
Detyrime për kontratat e sigurimeve	586,137	300,778	-	886,915
Rezervat për primet e pafituara	636,746	137,120	2,185	776,051
Depozita e risiguruesit	569,033	-	-	569,033
Detyrime nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	49,024	54,635	222	103,881
Totali i detyrimeve financiare	**1,840,940**	**492,533**	**2,407**	**2,335,880**
Pozicioni monetarë, neto	**30,063**	**56,730**	**1,119**	**87,912**

Aktivet dhe detyrimet e shoqërisë të shprehura në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

(Në '000 Lekë)	Në Lekë	Në EUR	Në USD	Totali
Aktivet				
Aktivet e risigurimit	571,559	141,770	10,044	723,373
Letra me vlerë me kosto të amortizuar	506,208	200,076	-	706,284
Depozita me afat me bankat	567,804	192,991	16,843	777,638
Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera	43,550	67,240	2,188	112,978
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to	55,555	25,306	5,074	85,935
Totali i aktiveve financiare	**1,744,676**	**627,383**	**34,149**	**2,406,208**
Detyrimet				
Borxhi i varur	-	66,562	-	66,562
Detyrime për kontratat e sigurimeve	551,743	253,492	-	805,235
Rezervat për primet e pafituara	616,893	175,192	13,744	805,829
Depozita e risiguruesit	551,970	-	-	551,970
Detyrime nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	68,637	65,972	443	135,052
Totali i detyrimeve financiare	**1,789,243**	**561,218**	**14,187**	**2,364,648**
Pozicioni monetar, neto	**(44,567)**	**66,165**	**19,962**	**41,560**

7. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Analiza e sensitivitetit

Tabela në vijim tregon me detaje ndjeshmërinë e shoqërisë në rritje dhe zvogëlim të lekut kundrejt valutave më të rëndesishme. Ky ndryshim në kurset e këmbimit është përdorur kur raportohet rrezikun e monedhës të huaj brenda vendit për personelin drejtues kryesor dhe paraqet vlerësimin e drejtimit të ndryshimit të arsyeshëm të mundshëm në kurset e këmbimit. Për çdo analizës së ndjeshmërisë ndikimi i ndryshimit në një faktor të vetëm është treguar, me supozimet e tjera të pandryshuara.

Analiza e ndjeshmërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018:

	Impakti	**Vlera**
EUR rritet 10% përkundrejt Lekut	Fitim	5,673
EUR ulet 10% përkundrejt Lekut	Humbje	(5,673)
USD rritet 10% përkundrejt Lekut	Fitim	112
USD ulet 10% përkundrejt Lekut	Humbje	(112)

Analiza e ndjeshmërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017:

	Impakti	**Vlera**
EUR rritet 10% përkundrejt Lekut	Fitim	6,617
EUR ulet 10% përkundrejt Lekut	Humbje	(6,617)
USD rritet 10% përkundrejt Lekut	Fitim	1,996
USD ulet 10% përkundrejt Lekut	Humbje	(1,996)

Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit përbëhet nga rreziku që vlera e flukseve të ardhshme monetare të një instrumenti financiar do të luhatet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe nga rreziku që maturitetet e aktiveve që mbartin interes do të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes dhe që janë përdorur për të financuar këto aktive. Kohëzgjatja brënda së cilës norma e interesit e një instrumenti financiar qëndron e fiksuar përcakton edhe shkallën e rrezikut të normës së interesit ndaj të cilit ekspozohet instrumenti financiar. Profili i normave të interesit që përmban shoqëria për instrumentat financiarë siç janë raportuar deri më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	**31 dhjetor 2017**
Instrumentat me norma fikse		
Aktivet finaciare		
Letra me vlerë me kosto të amortizuar	864,673	706,284
Depozita me afat me bankat	733,958	777,638
Detyrimi finaciarë		
Borxh i varur	-	(66,562)
Depozita e risiguruesit	(569,033)	(551,970)
Totali	**1,029,598**	**865,390**

Një ndryshim me 100 pikë në normën e interesit do të rriste ose zvogëlonte kapitalin me 8,922 mijë Lekë pas tatim fitimit (2017: 8,654 mijë Lekë). Kjo analizë supozon se të gjitha variablat e tjerë, sidomos kurset e këmbimit valutor, mbeten konstante.

7. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria nuk do të përmbushë obligimet e saj që lidhen me detyrime financiare brënda periudhës kur duhet të shlyhen. Rreziku i likuiditetit është një rrezik i moderuar i brendshëm për aktivitetin e biznesit të Shoqërisë sepse disa prej aktiveve të blera dhe detyrimeve të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqëria do të kërkonte shuma të konsiderueshme brënda një periudhe të shkurtër duke tejkaluar kërkesat normale për mjete monetare, ajo mund të përballej me vështirësi për të siguruar çmime tërheqëse.

Asetet financiare janë të detajuara duke u nisur nga maturiteti i tyre i përcaktuar në kontrata, ndërsa detyrimet financiare janë të detajura duke u nisur nga maturiteti i pritur, duke qënë se kontrata kërkon që detyrimi ndaj policmbajtësit të shlyhet në çdo kohë. Aktivet dhe detyrimet financiare më 31 dhjetor 2018 të paraqiten më poshtë:

	Më pak se 3 muaj	Midis 3 muaj dhe 1 vit	Midis 1 vit dhe 5 vjet	Totali
Aktivet				
Aktivet e risigurimit	36,659	412,876	235,240	684,775
Letra me vlerë me kosto të amortizuar	16,135	51,614	923,327	991,076
Depozita me afat me bankat	24,017	282,091	457,079	763,187
Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera	56,504	27,707	1,548	85,759
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to	54,627	-	-	54,627
Totali i aktiveve financiare	**187,942**	**774,288**	**1,617,194**	**2,579,424**
Detyrimet				
Borxhi i varur	-	-	-	-
Detyrime për kontratat e sigurimeve	44,346	248,336	594,233	886,915
Rezervat për primet e pafituara	44,344	723,947	7,759	776,051
Depozita e risiguruesit	7,257	9,806	551,970	569,033
Detyrime nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	103,881	-	-	103,881
Totali i detyrimeve financiare	**199,828**	**982,089**	**1,153,962**	**2,335,880**
Pozicioni i likuiditetit neto	**(11,886)**	**(207,801)**	**463,232**	**243,544**

Asetet dhe detyrimet e sigurimit nuk janë financiare dhe në kuadër të SNRF 4. Pozicioni i likuiditetit neto për periudhat 3 muaj deri në 1 vit mund të kompesohet nga depozitat që shoqëria ka në banka, të cilat janë shumë likuide dhe mund të përdoren në çdo rast, nëqoftëse është e nevojshme.

7. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Asetet financiare janë të detajuara duke u nisur nga maturiteti i tyre i përcaktuar në kontrata, ndërsa detyrimet financiare janë të detajura duke u nisur nga maturiteti i pritur, duke qënë se kontrata kërkon që detyrimi ndaj policmbajtësit të shlyhet në çdo kohë. Aktivet dhe detyrimet financiare më 31 dhjetor 2017 të detajuara sipas maturitetit kontraktual paraqiten më poshtë:

	Më pak se 3 muaj	Midis 3 muaj dhe 1 vit	Midis 1 vit dhe 5 vjet	Totali
Aktivet				
Aktivet e risigurimit	38,931	454,991	229,451	723,373
Letra me vlerë me kosto të amortizuar	994	48,228	773,941	823,162
Depozita me afat me bankat	82,768	292,007	434,837	809,612
Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera	83,997	22,121	6,860	112,978
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to	85,935	-	-	85,935
Totali i aktiveve financiare	**292,625**	**817,347**	**1,445,089**	**2,555,060**
Detyrimet				
Borxhi i varur	-	-	66,562	66,562
Detyrime për kontratat e sigurimeve	40,262	225,466	539,507	805,235
Rezervat për primet e pafituara	46,046	751,727	8,056	805,829
Depozita e risiguruesit	5,819	70,554	475,597	551,970
Detyrime nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	135,052	-	-	135,052
Totali i detyrimeve financiare	**227,179**	**1,047,747**	**1,089,722**	**2,364,648**
Pozicioni i likuiditetit neto	**65,446**	**(230,400)**	**355,367**	**190,412**

Menaxhimi i rrezikut të kapitalit

Struktura e kapitalit të Shoqërisë konsiston në kapital që i atribuohet mbajtësve të kapitalit të Shoqërisë, dhe përfshin kapitalin e paguar, rezervat dhe fitimin e mbajtur. Shoqëria menaxhon kapitalin për të siguruar që çdo vendndodhje të mbajë nivelet e kërkuara të kapitalit që siguron vijimësinë e aktivitetit dhe përputhshmërinë me kërkesat për kapital të rregullatorëve, ndërsa maksimizon kthimin ndaj aksionerëve përmes optimizimit të raportit të borxhit me kapitalin.
Më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017, kapitali aksioner i Shoqërisë është në përputhje me kërkesat mbi kapitalin e paguar të rregullatorëve të sigurimeve.

Në përputhje me ligjin "Për veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve", shoqëritë e sigurimeve në Shqipëri llogarisin kapitalin rregullator në datën e raportimit duke e krahasuar atë me aftësinë paguese të kërkuar. Kapitali i shoqërive të sigurimit duhet të paktën të jetë shuma më e lartë e fondit të garancisë të Shoqërisë në datën e raportimit dhe 150% e aftësisë paguese të kërkuar në përputhje me Ligjin e Sigurimeve. Në datën e raportimit 31 dhjetor 2018, aftësia paguese e shoqërisë është 453,188 mijë Lekë (2017: 473,784 mijë Lekë) (skedulet suplementare).

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Kapitali	20	601,387	526,166
Aftësia paguese e shoqërisë		453,188	473,784
150% e kërkuar e aftësisë paguese		255,294	242,210
Aftësia paguese e shoqërisë në % aftesise së kërkuar		**178%**	**196%**
Fondi i garancisë	15	393,375	381,315
Aftësia paguese e shoqërisë në % të aftësisë së kërkuar		**115%**	**124%**

7. Administrimi i Rrezikut Financiar (vazhdim)

Rreziqe të tjera

Ndryshimet në rregulloret shtetërore për segmentet e biznesit në të cilat Shoqëria operon mund të prekin përfitueshmërinë e saj. Biznesi i sigurimeve është subjekt i mbikqyrjeve gjithëpërfshirëse dhe zhvilluese. Qëllimi kryesor i këtyre rregulloreve është mbrojtja e policëmbajtësve. Ndryshimet në ligjet dhe rregulloret aktuale të sigurimit mund të ndikojnë mënyrën me të cilën Shoqëria drejton aktivitetin e biznesit dhe produktet që ofron. Për më tepër, përshtatja dhe amendimi i herë pas hershëm i ligjeve të sigurimit ose rregulloreve mund t'i bëjë ato më kufizuese ose të rezultojnë në kosto më të larta sesa kërkesat aktuale.

8. Administrimi i rrezikut të sigurimit

Shoqëria merr mbi vete rrezik të sigurimit përmes kontratave të sigurimit në të cilat merr parasysh rrezikun e humbjes nga personat apo organizatat që janë drejtpërdrejt subjekt i humbjes. Shoqëria është e ekspozuar ndaj pasigurisë që ka të bëjë me kohën, frekuencën dhe shkallën e dëmeve të lidhura me këto kontrata.

Rreziku i sigurimeve lidhet me pasigurinë e biznesit të sigurimeve. Përbërësit më të rëndësishëm të rrezikut të sigurimit janë rreziku i primit dhe rreziku i rezervës. Këto kanë të bëjnë me përshtatshmërinë e niveleve të normave të primit të sigurimeve dhe përshtatshmërinë e provigjoneve në lidhje me detyrimet e sigurimeve dhe bazën e kapitalit.

Rreziku i sigurimit është i pranishëm kur polica lëshohet përpara se ndonjë ngjarje e siguruar të ketë ndodhur. Rreziku është që shpenzimet dhe humbjet e shkaktuara do të jenë më të larta se shuma e polices. Rreziku i rezervës përfaqëson rrezikun që niveli absolut i provigjoneve teknike të vlerësohet ose që pretendimet aktuale do të luhaten rreth vlerës mesatare statistikore.

Menaxhimi i rreziqeve

Shoqëria menaxhon rrezikun përmes strategjisë së risigurimit dhe të marrjes në sigurim brënda kontureve të një menaxhimi risku të përgjithshëm. Vendosja e çmimeve bëhet bazuar në trendet dhe përvojat e kaluara. Ekspozimi menaxhohet duke pasur të dokumentuar limitet dhe kriteret e marrjes në sigurim. Risigurimet realizohen për t'i lehtësuar Shoqërisë efektin e humbjeve të mundshme nga ngjarjet individuale të mëdha apo katastrofave si dhe për të siguruar akses te specialistë të riskut dhe asistencë në menaxhimin e kapitalit. Policat e risigurimit shkruhen me risigurues të aprovuar ose mbi bazën e një marrëveshje proporcionale ose mbi bazën e një marrëveshje të tejkalimit të humbjes.

Kapitali rregullator menaxhohet gjithashtu (edhe pse jo vetëm) duke iu referuar rrezikut të sigurimit ndaj të cilit Shoqëria është e ekspozuar. Shoqëria shkruan polica për prona, detyrime dhe mjete motorrike kryesisht për kohëzgjatje mbi 12 muaj. Rreziqet më të rëndësishme vijnë prej katastrofave natyrore, ndryshimeve klimatike dhe katastrofave të tjera (ngjarje me frekuence të ulët dhe shkallë dëmi të lartë). Rreziku i përqëndruar vjen edhe prej një kontrate të vetme që i lëshohet policëmbajtësve të një tipi demografie të veçantë, brënda një zone gjeografike të caktuar ose tipeve të bizneseve tregtare. Ndryshueshmëria e rezultatit lehtësohet nëse Shoqëria mban një portofol të madh të përbërë nga shumë rreziqe të ngjashme.

Më poshtë jepet një përmbledhje e koncentrimit të provizioneve për dëme sipas tipit të kontratës duke iu referuar detyrimeve të sigurimit:

	31 dhjetor 2018			31 dhjetor 2017		
	Bruto	**Risigurimi**	**Neto**	**Bruto**	**Risigurimi**	**Neto**
Linja e biznesit						
Mjete motorike	854,999	(332,508)	522,491	749,872	(298,991)	450,881
Prona	19,792	(10,158)	9,634	44,753	(36,573)	8,180
Shëndeti dhe Aksidentet	11,188	(3,016)	8,172	5,915	(761)	5,154
Të tjera	936	(385)	551	4,694	(385)	4,309
Totali	**886,915**	**(346,067)**	**540,848**	**805,234**	**(336,710)**	**468,524**

8. Administrimi i rrezikut të sigurimit (vazhdim)

Më poshtë jepet një përmbledhje e koncentrimit të primeve sipas tipit të kontratës duke ju referuar detyrimeve të sigurimit:

	31 dhjetor 2018			31 dhjetor 2017		
	Bruto	**Risigurimi**	**Neto**	**Bruto**	**Risigurimi**	**Neto**
Linja e biznesit						
Mjete motorike	1,314,816	(600,705)	714,111	1,222,694	(607,150)	615,544
Pasuria	164,838	(79,386)	85,452	216,252	(137,855)	78,397
Shëndeti dhe Aksidentet	128,218	(44,620)	83,598	159,588	(53,605)	105,983
Të tjera	71,025	(56,465)	14,560	68,056	(47,424)	20,632
Totali	**1,678,897**	**(781,176)**	**897,721**	**1,666,590**	**(846,034)**	**820,556**

Më poshtë jepet një përmbledhje e ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të sigurimit për vitin 2018 dhe 2017:

	31 dhjetor 2018	**31 dhjetor 2017**
	Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të sigurimit *	**Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të sigurimit ***
Linja e biznesit		
Mjete motorike	*shënim më poshtë	*shënim më poshtë
Prona	127,661,650	139,550,271
Shëndeti dhe Aksidentet	33,483,358	29,323,282
Të tjera	22,622,262	17,658,358
Totali	**183,767,270**	**186,531,911**

* Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të sigurimit është bruto dhe nuk përfshin pjesën e risigurimit. Përsa i përket mjeteve motorike, ekspozimi bazohet në Ligjin Nr. 10 076, datë 12.02.2009 dhe në Ligjislacionin përkates të vendit të ndodhjes së aksidentit përsa i përket kartonit jeshil.

Dëmet aktuale të krahasuara me vlerësimet

Provizionet për koston përfundimtare të pritshme të shlyerjes së të gjitha kërkesave të ndodhura në lidhje me ngjarjet deri në atë datë, qoftë të raportuara apo jo, së bashku me shpenzimet e trajtimit të dëemeve, shumat e paguara më herët, bëhen në datën e raportimit.

Detyrimi për kërkesat e raportuara (të raportuara por jo të paguara ose "RBNS") vlerësohet rast pas rasti, duke pasur parasysh rrethanat e kërkesës, informacionin në dispozicion dhe dëshmitë historike të madhësisë së pretendimeve të ngjashme. Rezervat e dëmeve rishikohen rregullisht dhe përditësohen kur lindin informacione të reja.

Vlerësimi i dëmeve të ndodhura, por jo të raportuara ("IBNR") në përgjithësi i nënshtrohet një shkalle më të lartë pasigurie sesa kërkesat e raportuara. Aktuarët e shoqërisë kryesisht vlerësojnë provigjonet e IBNR duke përdorur teknika statistikore për të ekstrapoluar e të dhëna historike me qëllim vlerësimin e kostove përfundimtare të dëmeve.

Duke qenë se këto metoda përdorin informacion historik të zhvillimit të dëmeve, ato supozojnë se modeli i zhvillimit të dëmeve historike do të shfaqet përsëri në të ardhmen. Ka raste që kjo nuk mund të jetë gjithmonë kështu, për të cilat, për aq sa ato mund të identifikohen, lejohet që të modifikohet metoda e përdorur.

Këto rastet mund të jenë:

- Ekonomike, ligjore, politike dhe sociale (duke rezultuar në nivele të ndryshme të inflacionit sesa ato të pritura);
- Ndryshime në përpilimin e kontratave;
- Luhajtje të rastit, duke përfshirë ndikime të mëdha tek humbjet.

Dispozitat e IBNR fillimisht vlerësohen në një nivel bruto dhe kryhet një llogaritje e veçantë për të vlerësuar madhësinë e rikuperimit të risigurimeve.

8. Administrimi i rrezikut të sigurimit (vazhdim)

Tabela e mëposhtme tregon dëmet aktuale të ndodhura të krahasuara me vlerësimet e mëparshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
RBNS		
Vlerësimet fillestare për dëmet	428,207	569,907
Rezultatet aktuale në lidhje me dëmet e ndodhura gjatë vitit	(187,664)	(357,993)
Vlerësimet përfundimtare për dëmet e periudhave të mëparshme	(263,190)	(248,186)
Shmangia në Lekë	**(22.647)**	**(36,272)**
Shmangia në %	**-5.29%**	**-6.36%**
IBNR		
Vlerësimet fillestare për dëmet	358,450	307,002
Rezultatet aktuale në lidhje me dëmet e ndodhura gjatë vitit	(61,018)	(84,307)
Vlerësimet përfundimtare për dëmet e periudhave të mëparshme	(273,043)	(211,284)
Shmangia në Lekë	**24,389**	**11,411**
Shmangia në %	**6.8%**	**3.72%**
Shmangia totale në %	**0.2%**	**-2.84%**

Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve

Detyrimet e sigurimit llogariten duke përdorur supozime historike.

Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve për sigurimin e jo-jetës është i kufizuar në pjesën e paskaduar të kontratave ekzistuese. Ai kryhet duke krahasuar vlerën e pritshme të dëmeve dhe shpenzimeve që i atribuohen periudhes në fuqi me shumën e primeve të pafituara në lidhje me këto polica pas zbritjes së kostove të drejtpërdrejta që kanë të bëjnë me sigurimin.

Flukset monetare të pritshme në lidhje me kërkesat dhe shpenzimet vlerësohen duke ju referuar përvojës gjatë pjesës së skaduar të kontratës, të rregulluar për humbjet individuale të cilat nuk priten të përsëriten.

Testi i mjaftueshmërisë i detyrimeve i shoqërisë (LAT) rezulton me një URR prej 5,974 mijë Lekë për Kasko dhe 2,875 mijë Lekë për sigurimin e shëndetit.

Një rritje prej 10% në raportin i kombinuar do të rezultonte me nje URR shtesë prej 11,629 mijë Lekë. Një zbritje prej 10% do të eleminonte URR.

8. Administrimi i rrezikut të sigurimit (vazhdim)

Tabela e mëposhtme tregon zhvillimin gradual të vlerësimit të dëmeve përfundimtare sipas pretendimeve të bëra gjatë vitit. Vlerësimi ndryshoi në periudha individuale në varësi të kërkesave aktuale të paguara. Shuma bruto e provigjoneve është totali i provigjoneve të RBNS dhe IBNR. Krahasimi i vlerësimeve statistikore të provizioneve të mjaftueshme me shumën bruto të provigjoneve sugjeron nivele të mjaftueshme të provigjoneve për dëmet. Vlerësimet e dëmeve për linjat e biznesit me dëme materiale të bëra ose të vlerësuara nuk janë përfshirë në tabelë.

	2018	2017	2016	2015	2014	2013	2012	2011	2010	2009	2008	Totali:
Vlerësimi i kërkesave kumulative												
- Në vitin e nënshkrimit	503,891	517,247	472,206	625,788	312,910	224,298	380,980	255,419	108,274	97,145	31,961	-
- Një vit më vonë		540,377	482,456	626,464	350,458	287,040	381,784	247,861	390,085	99,429	13,043	31,961
- Dy vite më vonë			509,381	696,953	337,655	288,662	439,968	297,504	262,954	347,461	5,425	110,188
- Tre vite më vonë				701,154	341,102	315,187	455,820	313,647	329,394	337,229	154,399	213,128
- Katër vite më vonë					350,773	334,767	453,694	321,980	331,612	365,536	40,189	1,147,365
- Pesë vite më vonë						343,530	466,242	349,385	339,368	374,928	55,859	1,269,213
- Gjashtë vite më vonë							504,751	360,314	389,858	376,790	44,943	1,654,373
- Shtatë vite më vonë								375,334	402,148	390,023	44,776	2,105,049
- Tetë vite më vonë									419,244	420,509	26,580	2,803,642
- Nëntë vite më vonë										437,455	9,711	3,361,052
- Dhjetë vite më vonë											7,676	4,031,450
Vlerësimi i kërkesave kumulative	503,891	540,377	509,381	701,154	350,773	343,530	504,751	375,334	419,244	437,455	7,676	4,693,564
Pagesat kumulative	219,531	390,762	403,666	626,548	309,164	300,466	459,785	318,723	382,525	435,078	-	3,846,238
Vlera e njohur në bilanc	**284,359**	**149,615**	**105,714**	**74,606**	**41,609**	**43,074**	**44,965**	**56,611**	**36,719**	**2,377**	**7,676**	**847,326**

8. Administrimi i rrezikut të sigurimit (vazhdim)

Menaxhimi rishikon vlerësimin për dëmet dhe supozimet duke u bazuar në zhvillimet e dëmeve aktuale dhe bën rregullimet e duhura në metodologjinë e vlerësimit të dëmeve.Në vitin aktual, ka pasur një besim më të madh ndaj metodologjive aktuariale të tilla si trekëndëshi i dëmeve.

Supozimet që kanë efektin më të madh në matjen e detyrimeve të sigurimeve të jo-jetës janë si më poshtë:

Raporti i pritshëm i dëmeve. Raporti i pritur i dëmeve përfaqëson raportin e dëmeve të paguara dhe kërkesave të pritshme të shkaktuara për primet e fituara duke përjashtuar pjesën e risiguruesit në primet e fituara dhe kërkesat e paguara dhe të pritura (ndryshimet në IBNR dhe RBNS). Supozimet në lidhje me raportet e pritshme të dëmeve për vitin e fundit të aksidentit, sipas klasës së biznesit, kanë më së shumti ndikim në nivelin e provizioneve.

Faktorët limit. Për bizneset me liimte te larta, niveli i provizionit ndikohet në mënyrë të konsiderueshme nga vlerësimi i zhvillimit të dëmeve nga viti i fundit i zhvillimit për të cilin ka të dhënat historike deri në zgjidhjen përfundimtare. Këto faktorë vlerësohen me maturi në bazë të përvojës.

Skontime. Provizionet e dëmeve të jo-jetës nuk janë skontuar.

Zhvillimi i dëmeve. Dëmet e ndodhura përgjithësisht përpunohen nga shoqëria për një periudhë të shkurtër dhe normalisht mbyllen me një vit. Kërkesat e kartonit jeshil kanë tendencë të kenë periudhë më të gjatë të por jo të tejkalojnë shumë gjatë një vit. Në përvojën e shoqërisë, zhvillimi i dëmeve nuk ndryshon materialisht nga vlerësimet fillestare.

Supozime dhe sensitiviteti. Rreziqet e lidhura me kontratat e sigurimit të jo-jetës janë komplekse dhe subjekt i një numri variablash që e komplikojnë analizën kuantitative të sensitivitetit. Shoqëria përdor teknika statistikore dhe aktuariale duke përfshirë treguesë të tillë si raporti i humbjes së pritur.

Marrëveshjet e risigurimit të shoqërisë përfshijnë "quota share", "excess", "stop-loss" ose "mbulimin e katastrofave". Efekti i një marrëveshjeje të tillë risigurimi është se shoqëria nuk duhet të pësojë humbje totale të sigurimeve neto prej më shumë se 250,000 mijë euro në një vit të caktuar, që është ekspozimi maksimal për MTPL dhe Prona dhe Inxhinierike. Linjat e tjera të biznesit kanë ekspozime më të ulëta. Përveç programit të përgjithshëm të risigurimit të shoqërise, klientëve u lejohet blerja e sigurimit shtesë nga risigurimet.

Shoqëria e konsideron si të mjaftueshëm detyrimin për dëmet e jo-jetës në sigurim që njihet në pasqyrën e pozicionit financiar. Megjithatë, përvoja aktuale do të ndryshojë nga rezultati i pritur.

Një pamje e përgjithshme e analizës së sensitivitetit që tregon impaktin në fitimin perpara taksave jepet më poshtë. Për një sensitivitet të tillë, shfaqet ndikimi i një ndryshimi në një faktor të vetëm, me supozimet e tjera të pandryshuara.

	Impakti	2018	Impakti	2017
Raporti i dëmeve				
5% rritje në raportin e dëmeve	humbje	23,432	humbje	21,375
5% rënie në raportin e dëmeve	fitim	23,432	fitim	21,375
Raporti i shpenzimeve				
5% rritje në raportin e shpenzimeve	humbje	15,330	humbje	17,577
5% rënie në raportin e shpenzimeve	fitim	15,330	fitim	17,577
Raporti i kombinuar				
5% rritje në raportin e kombinuar	humbje	38,762	humbje	38,952
5% rënie në raportin e kombinuar	fitim	38,762	fitim	38,952

9. Shënime shpjeguese për përcaktimin e vlerës së drejtë

Matjet e vlerës së drejtë për qëllime matjeje dhe / ose prezantimi analizohen sipas nivelit të hierarkisë së vlerës së drejtë si vijon: (i) niveli i parë janë matjet me çmime të kuotuara (të parregulluara) në tregjet aktive për aktivet ose detyrimet identike, (ii) matjet e nivelit të dy janë teknikat e vlerësimit me të gjitha informacionet materiale të vëzhgueshme për aktivin ose pasivin, ose drejtpërdrejt (dmth. si çmime) ose indirekt (të derivuara nga çmimet); dhe (iii) matjet e nivelit të tretë janë vlerësime që nuk bazohen në të dhënat e vëzhgueshme të tregut pra, inputet e padukshme). Menaxhimi zbaton gjykimin për kategorizimin e instrumenteve financiare duke përdorur hierarkinë e vlerës së drejtë. Nëse një matje e vlerës së drejtë përdor informacione të vëzhgueshme që kërkojnë një rregullim të rëndësishëm, kjo matje është një matje e Nivelit 3. Rëndësia e një informacioni vlerësohet në matjen e vlerës së drejtë në tërësinë e saj.

Shoqëria nuk ka aktive të matura me vlerën e drejtë në datën e raportimit.

Aktivet dhe detyrimet që nuk maten me vlerën e drejtë, por për të cilat vlera e drejtë është e njohur

Vlera e drejtë e analizuar sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë dhe vlera kontabël e aktiveve dhe detyrimeve që nuk maten me vlerën e drejtë janë si më poshtë. Të arkëtueshmet e sigurimeve nuk përfshihen pasi për ato nuk kërkohet vlera e drejtë.

	Hua dhe të arkëtueshme	Të tjera me kosto të amortizuar	Vlera kontabël totale	Vlera e drejtë
31 dhjetor 2018				
Depozita me afat me bankat	733,958	-	733,958	733,958
Aktive financiare të mbajtura në maturim	864,673	-	864,673	910,862
Mjete monetare e ekuivalente me to	54,627	-	54,627	54,627
Borxh i varur	-	-	-	-
31 dhjetor 2017				
Depozita me afat me bankat	777,638	-	777,638	777,638
Aktive financiare të mbajtura në maturim	706,284	-	706,284	761,993
Mjete monetare e ekuivalente me to	85,935	-	85,935	85,935
Borxh i varur	-	66,562	66,562	66,562

Aktivet financiare të mbajtura me koston e amortizuar. Vlera e drejtë e instrumenteve me norma të luhatshme dhe instrumenteve afatshkurtër është normalisht vlera e tyre kontabël. Vlera e drejtë e vlerësuar e instrumentave të normës fikse të interesit bazohet në flukset monetare të ardhshme të parashikuara që priten të skontohen me normat aktuale të interesit për instrumente të reja me rreziqe të ngjashme kreditore dhe maturime të mbetura. Vlera e drejtë e investimeve të mbajtura deri në maturim është përcaktuar në bazë të çmimeve të kuotuara të shpallura nga Banka e Shqipërisë për të njëjtin instrument duke marrë në konsideratë maturim të ngjashëm me maturimin e instrumenteve të mbajtura nga shoqëria. Detyrimet financiare të shoqërisë janë afatshkurtra dhe vlerat e tyre të mbetura zakonisht janë të barabarta me vlerat e tyre të drejta.

10. Aktive të trupëzuara dhe të patrupëzuara

	Mjete motorike	Mobilje dhe pajisje zyre	Kompjuter	Të patrupëzuara	Total
Kosto					
Më 1 janar 2017	33,271	51,210	24,190	15,553	124,224
Shtesa	8,953	3,677	1,492	5,898	20,020
Pakësime	-	(21)	(3,863)	-	(3,884)
Më 31 dhjetor 2017	42,224	54,866	21,819	21,451	140,360
Shtesa	3,684	13,934	5,880	18,690	42,188
Pakësime	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2018	**45,908**	**68,800**	**27,699**	**40,141**	**182,548**
Amortizimi I akumuluar					
Më 1 janar 2017	(19,038)	(34,338)	(17,178)	(10,049)	(80,603)
Shpenzimi i vitit	(4,453)	(4,054)	(1,936)	(2,275)	(12,718)
Pakësime	-	7	3,528	-	3,535
Më 31 dhjetor 2017	(23,491)	(38,385)	(15,586)	(12,324)	(89,786)
Shpenzimi i vitit	(3,867)	(4,532)	(2,540)	(5,687)	(16,626)
Pakësime	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2018	**(27,358)**	**(42,917)**	**(18,126)**	**(18,011)**	**(106,412)**
Vlera kontabël neto					
Më 31 dhjetor 2017	**18,733**	**16,481**	**6,233**	**9,127**	**50,574**
Më 31 dhjetor 2018	**18,550**	**25,883**	**9,573**	**22,130**	**76,136**

Metoda e përdorur për llogaritjen e amortizmit është ajo lineare gjatë jetës së dobishme të vlerësuar të aktiveve. Shpenzimi i amortizimit njihet në "shpenzimet administrative".

11. Aktive të mbajtura për investime

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Gjendja në 1 janar	198,995	209,468
Zhvlerësimi për vitin	(9,950)	(10,473)
Gjëndja në 31 dhjetor	**189,045**	**198,995**

Aktive të mbajtura për investim përfshin ndërtesat e transferuara nga aktive të trupëzuara, bazuar në vendimin e menaxhimit në dhjetor 2012, duke qenë se Shoqëria e dha me qira te palët e treta dhe nuk e ka më në përdorim. Vlera e drejtë e investimeve në ndërtesën e ndodhur në Lagjia Punetore, Shkalla 1, kati 4, Gjirokaster është 12,184 mijë Lekë ndërsa ajo e ndodhur në Rruga Dritan Hoxha, Tirana, është 2,301 mijë Euro (Lekë 305,917 mijë) e përcaktuar nga ekspertë të jashtëm e të specialiazur të cilët kanë kualifikimet dhe eksperiencën e duhur në kategorinë përkatesë të aktiveve që kanë vlerësuar. Aktivet e mbajtura për investim maten nga shoqëria me kosto minus zhvlerësimin dhe humbjet nga zhvlerësimi, aty ku është e zbatueshme.

12. Aksione në shoqëri të lidhura

Aksionet në shoqeri të lidhura prej 12,566 mijë lekë (2017: 9,316 mijë lekë) përfaqësojnë investimin e Shoqërisë në 50% të aksioneve të VIG Services Shpk, një entitet i krijuar në 2012 si një qendër shërbimesh e përbashkët që siguron shërbime menaxhimi ndaj entiteteve të VIG që operojnë në Shqipëri.

13. Aktive të risigurimit

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Pjesa e risiguruesve në primin e pafituar	338,709	386,663
Pjesa e risiguruesve në dëmet e raportuara	346,066	336,710
Totali	**684,775**	**723,373**

Aktivet e risigurimit të shoqërisë nuk janë të siguruara dhe as të kaluara në afat apo të provizionuara. Aktivet monitorohen sipas vlerësimit të kredisë. Për fund vitin 31 dhjetor 2018 dhe 2017 rreziku i kredisë të primeve të ceduara të risigurimit sipas vlerësimit (kërkesë e legjislacionit lokal) është si më poshtë:

	2018				2017			
	Prime të ceduara		Aktive risigurimi		Prime të ceduara		Aktive risigurimi	
	Lekë	% e totalit	Lekë	% e totalit	Lekë	% e totalit	Lekë	% e totalit
Vlerësimi								
A	8,479	1%	1,266	1%	2,313	1%	-	0%
AA-	4,302	1%	-	0%	18,647	2%	6,517	2%
A+	748,717	96%	672,812	98%	812,784	96%	715,627	98%
A-	136	0%	68	0%	9,458	1%	581	0%
AA	15,755	2%	9,070	1%	602	0%	107	0%
AA+	1,358	0%	774	0%	266	0%	151	0%
B+	2,429	0%	785	0%	1,964	0%	390	0%
Totali	**781,176**	**100%**	**684,775**	**100%**	**846,034**	**100%**	**723,373**	**100%**

14. Letra me vlerë me kosto të amortizuar

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Totali në vlerë nominale	807,337	671,130
Primi i paamortizuar	43,508	25,265
Interes i përllogaritur	13,828	9,889
Totali	**864,673**	**706,284**

Shoqëria ka investuar në obligacione të emetuara nga shteti shqiptar, në Euro, me maturitet Nëntor 2020 (Normë interesi 5.75%), obligacione qeveritare të blera nëpërmjet bankave, me maturitet Korrik 2019 - Korrik 2026 (Normë interesi 4.95% - 9.25%) dhe obligacione qeveritare me maturitet deri në Nëntor 2020 – Janar 2028 (Normë interesi 2.64% - 7%). Bazuar në raportin e publikuar nga Moody's (shkurt 2019), Shqipëria vlëresohet me B1 dhe me perspektivë të qëndrueshme. Vlera e drejtë e aktiveve financiare është pasqyruar në shënimin 9.

15. Depozita me afat me bankat

Depozitat me afat me bankat më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë::

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Depozita bankare	318,292	381,643
Fondi i garancisë	393,375	381,315
Interes i perllogaritur nga depozitat	22,291	14,680
Totali i depozitave dhe fondit të garancisë	**733,958**	**777,638**

Fondi i garancisë përbëhet nga depozitat bankare të bllokuara pranë bankave tregtare të Republikës së Shqipërisë. Fondi i garancisë mund të investohet vetëm përmes sistemit bankar në depozita me afat ose aktive financiare të mbajtura deri në maturim dhe nuk është disponibël për operacione të përditshme.

Në përputhje me Nenin 98 te Ligjit për Sigurimet, përsa i përket fondit të garancisë, Shoqëria mban një minimum prej 1/3 të nivelit të kërkuar të marzhit të aftësisë paguese por jo më pak se 370 milion Lekë, në aktive financiare të mbajtura deri në maturim dhe depozita me afat me maturitet prej jo më pak se 1 vit. Në 31 dhjetor 2018, fondi i garancisë është 393,375 mijë lekë (2017: 381,315 mijë lekë).

Depozita me afat me bankat janë të përbëra nga valuta në lekë dhe valuta të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 si më poshtë:

	31 dhjetor 2018		31 dhjetor 2017	
	Vlera	Interesi në %	Vlera	Interesi në %
Në Lekë	587,848	2.24%	555,840	2.11%
Në USD	-	-	16,665	0.7%
Në EUR	123,819	1.14%	190,453	0.92%
Total	**711,667**		**762,958**	

Depozitat bankare pa përfshirë fondin e garancisë kane maturitet nga 12 muaj deri në 3 vjet.
Mjete monetare e ekuivalente me to dhe depozita me afat me bankat të shoqërisë janë vendosur në institucionet finaciare si më poshtë:

Vlerësimi	31 dhjetor 2018		31 dhjetor 2017	
	Mjetet monetare dhe depozitat	Nga të cilat mjete monetare (shënim 19)	Mjetet monetare dhe depozitat	Nga të cilat mjete monetare (shënim 19
B	317,422	7,504	28,333	2,333
B-	122,269	4,573	35,849	1,679
B+	207,642	25,932	31,781	3,486
B2	-	-	191,449	25,154
BBB	-	-	52,504	2,504
BBB-	104,557	12,215	201,412	24,937
BBB+	-	-	84,184	19,224
CCC+	14,326	4,326	41,809	1,832
Not rated	78	78	181,449	4,663
Totali	**766,294**	**54,628**	**848,770**	**85,812**

15. Depozita me afat me bankat (vazhdim)

Shoqëria operon me bankat lokale të cilat janë kryesisht filiale të grupeve bankare ndërkombëtare. Llogaritë me bankat nuk janë të siguruara. Për shkak se disa banka shqiptare vlerësohen nga agjensitë ndërkombëtare të vlerësimit, Shoqëria përdor vlerësimet e kreditit të aksionerëve më të mëdhenj të bankave për të marrë vendimet e saj të investimeve si dhe raportet tremujore të Bankës së Shqipërisë mbi bankat që operojnë në tregun shqiptar. Balancat që klasifikohen si not rated nuk janë as në vonesë, as të zhvlerësuara. Rankimi CCC+ përfshin balancat pranë filialeve të bankave greke dhe reflekton situatën në Greqi. Megjitëatë këto filiale kanë treguar stabilitet, duke kaluar me sukses "stress tests" të bëra nga Banka e Shqipërisë. Ne këto kushte, Shoqëria nuk i konsideron këto balanca si rrezk të lartë të kredisë. Asnjë prej balancave nuk është ne vonesë dhe as e zhvlerësuar.

16. Aktive të tjera

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Fondi i garancisë për Kartonin Jeshil	52,112	56,136
Shpenzime të parapaguara	20,686	2,478
Inventari	1,869	2,247
Të arketueshme nga dëmet	1,258	6,272
Paradhënie personeli	543	853
Totali	**76,468**	**67,986**

17. Shpenzime të shtyra të marrjes në sigurim

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Komisionet e agjentëve dhe kosto të tjera	210,341	226,625
Të ardhura nga komisionet e risigurimit	(23,440)	(28,730)
Totali	**186,901**	**197,895**

Lëvizjet në shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Në 1 janar	226,625	191,071
Rritja e shpenzimeve të shtyra të marrjes në sigurim	184,838	227,164
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim, shpenzuar	(201,122)	(191,610)
Më 31 dhjetor	**210,341**	**226,625**

18. Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimeve dhe të tjera

Të arkëtueshmet nga sigurimet përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Të arkëtueshme nga agjentët dhe policëmbajtësit	61,606	102,014
Të arkëtueshme nga Shoqëritë e sigurimit	24,153	10,964
Totali	**85,759**	**112,978**

Të arkëtueshmet bruto dhe neto nga zbritja e të arkëtueshmeve të dyshimta paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Të arkëtueshmet nga sigurimet, bruto	110,676	131,895
Minus: Zbritja nga fondi i provizonit	(24,917)	(18,917)
Të arkëtueshmet nga sigurimet, neto	**85,759**	**112,978**

Lëvizjet në zbritjet për humbje nga zhvlerësimet detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Gjendja fillestare	18,917	20,252
Zhvleresimi per vitin	6,000	8,816
Fshirë	-	(10,151)
Balanca në 31 dhjetor	**24,917**	**18,917**

18. Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimeve dhe të tjera (vazhdim)

Shoqëria administron ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kredisë në baza të rregullta duke monitoruar nga afër të arkëtueshmet nga sigurimi. Cilësia e kredisë e sigurimeve dhe e arkëtueshmeve të tjera paraqitet më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
As me vonesë as të zhvlerësuara	74,320	97,566
Me vonesë por të pa zhvlerësuara	14,328	12,241
Të provizionuara	22,028	22,088
Totali i të arkëtueshmeve bruto	**110,676**	**131,895**
Minus: Zbritja nga fondi i zhvlerësimit	(24,917)	(18,917)
Totali	**85,759**	**112,978**

Nuk ka asnjë vlerësim të kredisë për të arkëtueshmet që rrjedhin nga kontratat e sigurimit. Të arkëtueshmet nga agjentët dhe shoqëritë e sigurimit nuk janë as të kaluara as të dëmtuara.

Të arkëtueshmet nga mbajtësit e policave, as të ardhurat e vonuara, as të dëmtuarit (bruto) nuk janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Paguar pas datës së raportimit	12,464	12,386
Të arkëtueshme që kanë kaluar me vonesë pas datës së raportimit	-	-
Totali	**12,464**	**12,386**

Të arkëtueshme të zhvlerësuara (bruto) nga policëmbajtësit deri më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 bazuar në statusin e tyre janë paraqitur më poshtë.

	31 dhjetor 2018			
	Bruto	**Zhvlerësime**	**Neto**	**%**
Pa vonesë	74,320	-	74,320	82%
1 deri 3 muaj	14,329	-	14,328	23%
3 muaj deri 1 vit	5,285	(8,174)	(2,889)	-5%
Me shume se 1 vit	16,743	(16,743)	-	0%
Totali	**110,676**	**(24,917)**	**85,759**	**100%**

	31 dhjetor 2017			
	Bruto	**Zhvlerësime**	**Neto**	**%**
Pa vonesë	97,566	-	97,566	86%
1 deri 3 muaj	12,241	-	12,241	11%
3 muaj deri 1 vit	4,759	(1,836)	2,923	3%
Me shume se 1 vit	17,329	(17,081)	248	13%
Totali	**131,895**	**(18,917)**	**112,978**	**100%**

19. Mjete monetare dhe ekuivalente me to

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Para në dorë	77	123
Para në bankë	*54,550*	*85,812*
në Lekë	22,971	58,876
në EUR	29,511	21,861
në USD	2,068	5,075
Totali	**54,627**	**85,935**

20. Kapitali aksionar

Më 31 dhjetor 2018 shoqëria ka një kapital të paguar prej 417,471 mijë lekë (2017: 417,471 mijë lekë). Kapitali aksionar është i ndarë në 122,800 aksione secili me një vlerë nominale prej 3,399.6 lekë (2017: 122,800 lekë). Më 31 dhjetor 2018 struktura e aksionerëve ishte si vijon:

	Nr. aksione	Vlera në '000 lekë	Në %
Vienna Insurance Group AG Ëiener Versicherung Gruppe	110,500	375,640	89.98%
Z. Gentian Sula	12,300	41,831	10.02%
Totali	**122,800**	**417,471**	**100%**

Rezerva e rrezikut të sigurimit krijohet bazuar në Nenin 93 të Ligjit për Sigurimet dhe është e barabartë me një të tretën e fitimeve të periudhës së mëparshme nëse fitimet nuk përdoren për të mbuluar humbje të akumuluara të trashëguara prej viteve të mëparshme. Kjo rezervë nuk rritet më tepër se 30% e primeve mesatare të arkëtuara në dy vitet e fundit. Kjo rezervë krijohet për të garantuar aftësinë paguese dhe fondin e garancisë.

21. Borxh i varur

Marrëveshja e borxhit të varur u nënshkrua më 22 dhjetor 2014 midis Vienna Insurance Group dhe shoqërisë me maturim përfundimtar më 22 dhjetor 2019. Gjatë vitit, Shoqëria ka shlyer në total borxhin.

22. Detyrime për kontratat e sigurimeve

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Gjendja më 1 janar		
Detyrime bruto të sigurimeve për humbje dhe rregullime të humbjeve	805,235	888,344
Rimarrje nga risigurimet (Shënimi 14)	(336,710)	(434,041)
Detyrime neto të sigurimeve për humbje dhe rregullime të humbjeve	**468,525**	**454,303**
Dëme të ndodhura	468,636	427,491
Dëme të paguara	(396,313)	(413,269)
Rezerva neto për humbje dhe rregullime të humbjeve	**540,849**	**468,525**
Rimarrje nga risigurimet (Shënimi 14)	346,066	336,710
Rezerva bruto për humbje dhe rregullime të humbjeve	**886,915**	**805,235**
Ndryshimi bruto në rezervat e sigurimit të dëmeve	(81,680)	83,110
Rimarrje nga risigurimet	9,356	(97,331)
Ndryshimi në rezervat e sigurimit, neto	**(72,324)**	**(14,220)**

Ndryshimi bruto në rezervat e sigurimit të dëmeve përbëhet nga ndryshimi bruto në rezervat për dëmet e raportuara por ende të pashlyera dhe në dëmet e ngjara por ende të paraportuara. Më datën e publikimit të pasqyrave financiare rezervat për detyrimet dhe humbjet e sigurimit për 2018 nuk kanë qënë aprovuar ende nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Dëmet e paguara sipas produkteve të sigurimit paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Mjete motorrike	458,728	616,149
Shëndeti	101,771	98,546
Prona	40,866	44,164
Të tjera	80	1,792
Totali	**601,445**	**760,651**

23. Rezerva e primit të pafituar

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Gjendja më 1 janar	805,829	734,773
Prime të shkruara gjatë vitit (shënimi 27)	1,678,897	1,666,590
Minus: Prime të fituara gjatë vitit	(1,708,675)	(1,595,534)
Gjendja më 31 dhjetor	**776,051**	**805,829**

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Ndryshimi bruto në rezerven e primit të pafituar	29,779	(71,056)
Ndryshimi në pjesën e risiguruesve	(47,955)	88,030
Ndryshimi në rezervën e primit të pafituar, neto	**(18,176)**	**16,974**

24. Depozita e risiguruesit

Më 31 dhjetor 2018 kjo depozitë është 569,033 mijë lekë (2017: 551,970 mijë lekë). Shoqëria nënshkroi një marrëveshje me VIG Holding në mënyrë që të gjitha detyrimet e risigurimit me VIG Holding të depozitohen nga shoqëria në një bankë lokale tregtare me një vlerësim të përshtatshëm të kredisë. Shoqëria i paguan VIG Holding një interes për vlerën kohore të parasë. Depozita mund të shfrytëzohet nga shoqëria për të shlyer kërkesat e papaguara ose të ardhshme të shkaktuara që kualifikohen për pagesë nga risiguruesit.

25. Detyime tatimore dhe të ngjashme

Detyrime tatimore dhe të ngjashme paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Taksa e primit	16,216	18,615
Tatimi mbi të ardhurat për pagat	3,700	7,752
Sigurimet shoqerore	3,090	3,194
Tatim ne burim	594	1,167
TVSH e pagueshme	754	488
Totali	**24,354**	**31,216**

26. Detyrime nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera

Detyrime tatimore dhe të tjera të ngjashme paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Taksa e primit	16,216	18,615
Tatimi mbi të ardhurat për pagat	3,700	7,752
Sigurimet shoqerore	3,090	3,194
Tatim ne burim	594	1,167
TVSH e pagueshme	754	488
Totali	**24,354**	**31,216**

27. Detyrime nga aktiviteti i sigurimit të tjera

Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Të pagueshme për aktivitet sigurimi	39,347	65,328
Të pagueshme ndaj risiguruesëve	23,590	44,728
Të pagueshme ndaj furnitorëve	17,338	11,103
Tarifa të pagueshme	14,745	4,555
Të pagueshme të tjera	8,861	9,338
Totali	**103,881**	**135,052**

28. Primet e shkruara bruto

Primet e shkruara bruto të sigurimit sipas produkteve detajohen si më poshtë:

	2018	2017
Mjete motorrike	1,314,816	1,222,694
Prona	153,212	175,324
Shëndeti	97,366	113,163
Detyrime	55,841	55,681
Të tjera	57,662	99,728
Totali	**1,678,897**	**1,666,590**

Primet shkruara bruto të sigurimit të mjeteve motorike detajohen si më poshtë:

	2018	2017
MTPL	998,271	918,629
Kartoni Jeshil	197,635	187,506
Politika Kufitare	76,940	77,703
Kasko	41,970	38,856
Totali	**1,314,816**	**1,222,694**

27. Prime të ceduara te risiguruesit

Primet e ceduara të risiguruesit sipas produkteve të sigurimit detajohen si më poshtë:

	2018	2017
Mjete motorrike	600,705	607,150
Prona	77,226	120,365
Detyrime	8,921	18,466
Të tjera	94,324	100,053
Totali	**781,176**	**846,034**

29. Të ardhura të tjera

	2018	2017
Qiraja dhe të ardhura të tjera nga shërbimet	4,555	3,321
Të tjera	8,056	3,423
Totali	**12,611**	**6,744**

30. Shpenzime të marrjes në sigurim

	2018	2017
Mjete motorike	357,797	359,468
Prona	52,825	64,477
Shëndeti dhe aksidentet	31,862	46,498
Detyrime	12,141	11,231
Të tjera	5,736	5,149
Ndryshim në shpenzimet e marrjes në sigurim, neto	10,994	(25,468)
Total	**471,355**	**461,355**

	2018	2017
Komisione	412,121	428,187
Pagat për departamentin e shitjes	44,311	54,887
Shpenzime të tjera të marrjes në sigurim	3,929	3,749
Totali	**460,361**	**486,823**

31. Shpenzime administrative

	2018	2017
Shpenzime personeli	102,595	91,348
Utilitete dhe Qira	35,623	38,169
Sherbime nga palë të treta	23,934	27,244
Shpenzime amortizimi	26,575	26,749
Reklama	31,282	17,529
Karburant e transport	9,665	8,226
Shërbime ligjore dhe këshillimi	9,703	8,165
Shpenzime IT	9,354	7,851
Shpenzime të tjera	7,713	4,838
Donacione	6,843	7,395
Penalitete e shpenzime gjyqësore	6,462	5,579
Telefon dhe postë	5,699	5,312
Udhëtime dhe dieta	4,754	4,912
Mirëmbajtja dhe shpenzime shërbimi	3,051	2,950
Shpenzime për taksa lokale	3,155	2,642
Përfaqësime	2,752	900
Totali	**289,160**	**259,809**

Në 2018, mesatarisht ka pasur 138 punonjës (2017: 140 punonjës). Shpenzimet e personelit janë paraqitur si më poshtë:

	2018	2017
Paga dhe shpërblime	93,005	82,780
Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	9,590	8,568
Totali	**102,595**	**91,348**

32. Të ardhura nga komisionet e risigurimit

Të ardhurat nga komisionet e risigurimit janë paraqitur si më poshtë:

	2018	2017
Mjete motorike	409,556	338,980
Prona	30,660	39,630
Detyrime	10,176	2,789
Të tjera	8,873	23,607
Totali	**459,265**	**405,006**

33. Shpenzime të tjera të sigurimit

	2018	2017
Shpenzime për autoritetin	19,937	17,559
Kontribut për Byronë e Sigurimeve	8,859	6,241
Kontribut për Shoqatën e Sigurimeve	-	1,485
Shpenzime të tjera	11	355
Provizionim për dëme padi regresi	4,716	-
Total	**33,513**	**25,640**

34. Të ardhura nga interesat

Të ardhurat nga interesi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 u fituan nga aktivet e meposhtëme:

	2018	2017
Interesi nga aktivet financiare të mbajtura deri në maturim	37,873	29,692
Interesi nga depozitat	16,245	15,170
Interesi nga llogaritë rrjedhëse dhe të tjera	9	8
Të ardhura nga investimet në VIG Services Sh.p.k	-	1,343
Totali	**54,127**	**46,213**

35. Të ardhura nga kursi i këmbimit, neto

	2018	2017
Fitime nga kursi i këmbimit, bruto	17,152	17,741
Humbje nga kursi i këmbimit, bruto	(45,494)	(28,786)
Totali	**(28,342)**	**(11,045)**

36. Tatim mbi fitimin

Tatim fitimi në Shqipëri është në normën 15% (2017: 15%) e të ardhurave të taksueshme. Shoqëria nuk ka diferenca të përkohshme në datën e raportimit, prandaj shpenzim I tatimit mbi fitimin përbëhet vetëm nga taksa aktuale.
Më poshtë paraqitet një rakordim i llogaritjes së tatim fitimit me normën tatimore të zbatueshme për shpenzimin e tatim fitimit.

	2018	2017
Humbja e vitit përpara tatim fitimit	93,308	83,963
Tatimi i përllogaritur me 15% (2017: 15%)	13,996	12,594
Efekti në tatim i shpenzime të pazbritshme	4,091	4,421
Tatimi i shtyrë, nga shpenzimet e panjohura të mëparshme	-	-
Shpenzime/(të ardhura) të tatimit mbi fitim	**18,087**	**17,015**

37. Angazhime dhe detyrime rastësore

Përgjatë rrjedhes të zakonshëm të biznesit, Shoqëria është përfshirë në pretendime dhe veprime ligjore të ndryshme. Sipas opinionit të Drejtimit, zgjidhja përfundimtare e këtyre çështjeve nuk do të ketë efekt negativ material në pozicionin financiar të Shoqërisë apo ndryshimin e aktiveve neto. Çështjet ligjore janë të zakonshme kur paditësit nuk bien dakord me vlerësimin e dëmit të bërë nga Shoqëria. Drejtimi i vlerëson pretendimet duke përdorur ekspertizë të jashtme dhe të brendshme përfshirë këtu edhe konsulencën ligjore. Drejtimi beson se këto vlerësime janë të përshtatshme por megjithatë pranon se rezultati final mund të jetë një shumë më e madhe ose më e vogël sesa ajo e parashikuar. Më 31 dhjetor 2018 kishte 18 raste ende në proçes për të cilat kërkesat e klientëve në mënyrë të agreguar ishin 4,000 mijë lekë më shumë sesa shuma e parashikuar nga shoqëria (2017: 45 raste ende në proçes për të cilat kërkesat e klientëve në mënyrë të agreguar ishin 18,000 mijë lekë më shumë sesa shuma e parashikuar nga shoqëria).

Fondi Kompesimit për MPTL

Shoqëritë e Sigurimit të cilat ofrojne sigurimin e detyrueshëm për mjetet motorrike në Shqipëri janë te detyruara të kontribuojnë pranë autoriteteve përkatëse fondin e kompesimit të sigurimit në bazë vjetore në përpjestim të tregut të MTPL-së që ato kanë patur përgjatë vitit të mëparshëm. Shuma dhe koha e pagesave e fondit të kompesimit aprovohet nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare ("AMF") në vijim te propozimit të Byrosë Shqiptare të Sigurimit. Shoqëria ka kryer pagesën për kontributin gjatë vitit.

Angazhime për Qiratë

Angazhimet minimale për qiratë e pa-anullueshme të zyrave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe vitin 2017 përbëhen si më poshtë:

37. Angazhime dhe detyrime rastësore (vazhdim)

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Jo më shumë se 1 vit	45,484	28,427
1- 5 vite	15,572	41,398
Totali	**61,056**	**69,825**

Angazhime të tjera

Ndryshimet e rregulloreve shtetërore për segmentet e biznesit në të cilat Shoqëria operon.

Biznesi i sigurimeve është subjekt i mbikqyrjes në Shqipëri. Qëllimi kryesor i këtyre rregulloreve është mbrojtja e policëmbajtësve. Ndryshimet në ligjet dhe rregulloret aktuale të sigurimit mund të ndikojnë mënyrën me të cilën Shoqëria drejton aktivitetin e biznesit dhe produktet që ofron. Për më tepër, përshtatja dhe amendimi herë pas hereshëm i ligjeve të sigurimit ose rregulloreve mund t'i bëjë ato më kufizuese ose të rezultojnë në kosto më të larta sesa kërkesat korrente.

38. Shënime shpjeguese për palët e lidhura

Shoqëria ka marrëdhënie të palëve të lidhura me shoqëri të cilat janë nën kontrollin e saj dhe nën kontroll të përbashkët të shoqërisë mëmë Vienna Insurance Group. Shoqëria ka gjithashtu marrëdhënie të palëve të lidhura me drejtorët dhe drejtuesit ekzekutivë.

Përgjatë vitit janë kryer transaksione me palët e lidhura si vijon:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Të ardhura		
Të ardhura nga komisionet e risigurimit		
VIG HOLDING	409,547	338,889
VIG RE	39,205	56,837
Shpenzime		
Prime të ceduara risiguruesve		
VIG HOLDING	(565,871)	(572,891)
VIG RE	(149,029)	(185,233)
Çmimi transferimit të ndërkompanive	(25,877)	(27,284)
Kompensimi I Drejtimit	(26,294)	(32,550)
Kontributet e pensionit	(3,333)	(4,126)
Totali	**(321,652)**	**(426,358)**

Në çdo datë raportimi, shumat e mëposhtme për palët e lidhura janë përfshirë në pasqyrën e pozicionit financiar:

	2018	2017
Menaxhimi dhe Aksionerët		
Aktive		
Aktive Risigurimi		
Vig Holding	-	1,858
VIG RE	8,667	10,068
Total	**8,667**	**11,926**
Detyrime		
Borxhi il varur		
Vig Holding	-	(66,562)
Depozita e risiguruesit		
Vig Holding	(569,033)	(551,970)
Të pagueshme nga risigurimi		
Vig Holding	(2,068)	(4,115)
VIG RE	(14,814)	(25,364)
Detyrime të tjera		
VIG Services Shpk	(3,999)	(3,514)
VIG RE	(5,973)	
SigmaInteralbanian Vienna Insurance Group	(174)	(8,984)
Makedonija Osiguruv	(1,373)	
Vig Holding	(1,967)	(1,826)
Totali	**(599,401)**	**(662,335)**

39. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje domethënëse që do të kërkonin rregullime apo paraqitje në këto pasqyra finaciare.

SKEDULE SUPLEMENTARE

Aftësia Paguese

Aftësia paguese sipas metodës së kapitalit neto më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhet si më poshtë:

Niveli aktual i aftësisë paguese:	**2018**	**2017**
Kapitali aksionar	417,471	417,471
Rezerva e sigurisë	41,747	41,747
Fitimet e mbajtura	142,169	65,917
Borxh i varur varur	-	66,562
Aktive afatgjata jo-materiale	(22,131)	(9,126)
Aksione në shoqëri të lidhura	(12,566)	(9,315)
Llogari të arkëtushme nga sigurimet dhe të tjera	(29,471)	(28,981)
Aktive të tjera	(84,031)	(70,492)
Niveli aktual i aftësisë paguese	**453,188**	**473,783**
Niveli i kerkuar i aftësisë paguese	**370,000**	**370,000**
Kapital Surplus/(Deficit)	**83,188**	**103,783**
Mjaftueshmëria e kapitalit	**I përmbushur**	**I përmbushur**

Aktive për mbulimin e detyrimeve të sigurimit

Në përputhje me vendimin e Qeverisë numër 96 datuar më 3 gusht 2008; shoqëritë e sigurimit që operojnë në Shqipëri nuk mund të investojnë më shumë se raportet e mëposhtme të aktiveve dhe investimeve që mbulojnë rezervat teknike dhe matematike:

			31 dhjetor 2018
Provizionet bruto teknike dhe matematike			
	Limiti i investimit si perqindje e provizionit bruto	**Limiti i investimit sipas ligjit**	**Aktive per mbulimin e detyrimeve te sigurimit**
Zëri i vetëm tokë dhe ndërtesa *	10% për pjese	332,593	177,871
Depozita me afat (duke përjashtuar fondin e garancisë)	Pa limit	pa limit	341,667
Tituj të tregtuar në tregje të parregulluara	10%	166,297	-
Letra me vlerë me kosto të amortizuar	Pa limit	pa limit	850,845
Aktive të risigurimit (klasifikimi mbi BBB)	Pa limit	pa limit	684,775
Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera të arkëtueshme (më pak se 3 muaj)	20%	332,593	57,546
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	3%	49,889	45,805
Investime në aktive fikse të ndryshme nga toka dhe ndërtesat	5%	83,148	54,004
Aktive të tjera	2%	33,259	52,113
Interes i llogaritur	5%	83,148	36,119
Totali			**2,300,745**
Provizionet teknike			**1,662,965**
Niveli i mbulimit të rezervave teknike			**138%**

* Shoqëria mund të investojë vetem në një zë të aktiveve të trupëzuara jo më shumë se 10% të totalit të provizionit teknik. Deri më 31 dhjetor 2018 shoqëria ka në pronësi dy ndërtesa.

Provizionet bruto teknike dhe matematike më 31 dhjetor 2017 përbëhen si më poshtë:

Provizionet bruto teknike dhe matematike			**31 dhjetor 2017**
	Limiti i investimit si perqindje e provizionit bruto	**Limiti i investimit sipas ligjit**	**Aktive per mbulimin e detyrimeve te sigurimit**
Zëri i vetëm tokë dhe ndërtesa *	10%	322,213	173,291
Depozita me afat (përveç fondit të garancisë)	no limit	pa limit	392,958
Tituj të tregtuar në tregje të parregulluara	10%	161,106	-
Letra me vlerë me kosto të amortizuar	no limit	pa limit	696,395
Aktive të risigurimit (klasifikimi mbi BBB)	no limit	pa limit	723,373
Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera të arkëtueshme (më pak se 3 muaj)	20%	322,213	140,133
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	3%	48,832	48,332
Investime në aktive fikse të ndryshme nga toka dhe ndërtesat	5%	80,553	41,445
Aktive të tjera	2%	32,221	-
Interes i llogaritur	5%	80,553	24,569
Totali			**2,240,496**
Provizi\onet teknike			**1,611,064**
Shkalla e mbulimit në përqindje			**139%**

* Shoqëria mund të investojë vetem në një zë të aktiveve të trupëzuara jo më shumë se 10% të totalit të provizionit teknik. Deri më 31 dhjetor 2017 shoqëria ka në pronësi dy ndërtesa.